

Në bazë të nenit 45 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit mbi vetëadministrimin lokal („Fl. zyrtare e RMZ“, nr. 42/03, 28/04, 75/05 dhe 13/06), Kuvendi i komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur më 26. 10. 2007,13.02.2009 dhe 13.04.2011 miratoi

STATUTIN E KOMUNËS SË ULQINIT

(teksti i spastruar)

Statuti është publikuar në „Fletën zyrtare MZ-dispozitat komunale „, nr.5/2007,9/2009 dhe 16/2011

DISPOZITAT KRYESORE

1. LËNDA E RREGULLIMIT (ORGANIZIMIT)

Neni 1

Komuna e Ulqinit (në tekstin vijues: Komuna), me Statutin e Komunës së Ulqinit (në tekstin vijues: Statutin) rregullon organizimin, punën dhe mënyrën e realizimit të vetëadministrimit lokal dhe këtë:

- të drejtat dhe detyrat e Komunës dhe mënyra e realizimit të tyre;
- punët dhe mënyrën e vendimmarrjeve të popullatës lokale;
- mënyrën dhe procedimin (veprimi) e pjesëmarrjes së popullatës lokale në justifikimet dhe vendimet për punët me interes të përbashkët;
- mënyrën dhe kushtet e kryerjes së punëve personale;
- finansimin dhe pasurinë e Komunës;
- mënyrën e sigurimit të organeve për punët publike dhe shërbimet publike;
- organizimin dhe mënyrën e punës së organeve, të administratës lokale dhe të shërbimeve publike të Komunës;
- mënyrën e prurjes së dispozitave;
- mënyrën e kryerjes së kontrollit mbi punën e organeve të Komunës dhe të shërbimeve publike;
- mënyrën e besueshmërisë së punëve të caktuara trupave punuese të Kuvendit komunal;
- statusin juridik, themelimin e simbolit, ditës së Komunës dhe mënyrën e shënimit të saj dhe
- çështje të tjera me rëndësi për funksionimin e vetëadministrimit lokal.

2. PUNËT DHE MËNYRA E VENDIMARRJES SË POPULLATËS LOKALE

Neni 2

Në Komunë realizohet plotësimi i nevojave me interes të drejtëpërdrejtë dhe me interes të përbashkët për popullatën lokale.

Me qëllim të krijimit të kushteve për kryerjen sa më të drejtëpërdrejtë dhe sa më efektive të punëve dhe për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e popullatës lokale vetëadministrimi lokal realizohet edhe në vetëadministrimin lokal.

Neni 3

Qytetarët marrin pjesë në vendimet mbi nevojat dhe interesat e veta drejtëpërdrejtë dhe përmes përfaqësuesëve të zgjedhur në organet e vetëadministrimit lokal.

„I huaji mund të realizojë disa të drejta në vetëadministrimin lokal me kushte dhe forma të bazuara në ligj.“

Neni 4

Qytetarët zgjedhin organet e Komunës në bazë të të drejtës zgjedhore të lirë, të përgjithëshme, të barabartë dhe të drejtëpërdrejtë në përputhje me ligjin.

Neni 5

Komuna krijon kushte, nxit dhe ndihmon pjesëmarrjen e popullatës lokale në realizimin e vetëadministrimit lokal nëpërmjet formave të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve në deklamimin dhe marrjen e vendimeve mbi punët me interes të përbashkët.

Neni 6

Me qëllim të plotësimit të kërkesave kulturore, sportive, arsimore, shëndetësore, informative e tj., popullata lokale merr pjesë në drejtimin e shërbimeve publike dhe personave të tjere juridik të cilët kryejnë autorizime publike dhe u bënë

shërbime qytetarëve, në mënyrën e caktuar me ligje të veçanta dhe dispozita të tjera.

3. TERRITORI DHE SELIA E KOMUNËS

Neni 7

Komuna ka cilësinë e personit juridik, emrin dhe territorin e përcaktuar me ligj. Komuna ka Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme .

Selia e Komunës është në Ulqin , Bul. „GJ.K.Skenderbeu pn“

Neni 8

Territori i Komunës së Ulqinit i përcaktuar me ligj, përfshin qytetin e Ulqinit dhe vendbanimet: Amull, Braticë, Mali i Brinjës, Bojk, Brajshë, Katërkollë, Shtoji i Naltë, Këllezna e Naltë, Shtoji Poshtë, Këllezna Poshtë, Darzë, Draginë, Gjerana, Zogaj, Zenelaj, Krythë e Ulqinit, Krythë, Kërriç, Kollomzë, Kodra, Kosiq, Kaliman, Kravari, Leskoc, Lisna Borë, Millë, Megjures, Pistull, Reç, Rashtishë, Sukubinë, Salç, Sutjel, Shëngjergj, Qyrkaj, Fraskanjel, Shas, Shtodër, Selitë, Rashtisha e Poshtme, Gjonza dhe Kravari i Poshtëm.

Neni 9

Kufijt territorial të vendbanimeve përcaktohen me Vendimin e Kuvendit komunal.

Vendimin mbi bashkimin, ndarjen dhe heqjen e vendbanimeve e miraton Kuvendi komunal.

Emrin dhe ndërrimin e emrit të vendbanimeve, të rrugëve dhe shesheve e përcakton Kuvendi komunal, me marrjen e mendimit të organit kompetent, vetëadministratës vendore në territorin e të cilit gjendet vendbanimi, rruga gjagjesisht sheshi.

4. SIMBOLET DHE FESTA

Neni 10

Komuna ka stemën dhe flamurin.

Stema ka formën e mburojës në të cilën figurativisht janë të komponuara të gjitha simbolet karakteristike për qytetin e Ulqinit: Kalaja me gurë në themele në bregun e detit, simboli i diellit i vendosur mbi Kala, degëza e ullirit me fruta, barka e vjetër antike me kokë ujku të këthyer kah barka, ndërsa stema ka kind të artë.

Flamuri i komunës është me ngjyrë të bardhë, me stemën e komunës në mes.

Përdorimi i stemës dhe flamurit rregullohen me Vendimin e Kuvendit Komunal.

Neni 11

Komuna ka festën.

Festa e Komunës është e shtuna e parë e muajit të prillit, e cila simbolizon përfundimin e mbledhjes së ullinjve, dalja e detarëve në det dhe fillimi i sezonit turistik.

Festa e Komunës shënohet me Mbledhjen solemne të Kuvendit Komunal dhe me forma të tjera kremitimi të përcaktuara me Rregulloren e punës së Kuvendit Komunal dhe me vendimin e Kuvendit Komunal.

5. VULA E KOMUNËS

Neni 12

Komuna dhe organet e saj kanë vulën.

Vula e Komunës ka formën e rumbullakët me diametër prej 32 mm dhe mban emrin:

Crna Gora - Mali i Zi, Opstina Ulcinj – Komuna e Ulqinit, Ulcinj – Ulqin“, në mes vula ka Stemën e Ulqinit.

Vula e organeve të Komunës, krahas elementeve nga paragrafi 2 të këtij neni përmban edhe emrin e organit.

Kuvendi komunal, me vendim të veçantë rregullon punimin, ruajtjen dhe asgjësimin e vulës dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e vulës.

6. DEKORATAT (MIRËNJOHJET) PUBLIKE

Neni 13.

Qytetarëve dhe personave juridik të komunës u jepen mirënjohje publike për sukseset e arritura të rëndësishme për zhvillimin e veprimtarive të caktuara apo për zhvillimin e Komunës në përgjithësi.

Dekoratat publike mund t'u ndahen edhe qytetarëve dhe personave juridike të komunave të tjera, organizatave dhe shtetasve të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare.

Dekoratat publike ndahen në Ditën e Komunës ose me ndonjë rast tjetër.

Neni 14

Dekoratat publike janë: shpallja e individit „Qytetar nderi“ i Komunës, shpërblimi i qytetit të Ulqinit dhe shpërblime të tjera.

Kushtet dhe mënyrën e propozimit dhe të zgjedhjes së kandidatit për ndarjen e shpërblimit nga paragrafi i mësipërm përcaktohet me vendimin e veçantë të Kuvendit Komunal të Ulqinit.

7. TË DREJTAT DHE LIRITË E PAKICAVE DHE Pjesëtarëve të tyre

Neni 15

Në komunë detyrimisht sigurohen dhe mbrohen të drejtat e pakicave konforme mbrojtjes juridike ndërkombëtare dhe dispozitave të vëndit.

Neni 16

Pakicat dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtën e shprehjes, ruajtjes, bartjes dhe të shfaqin publikisht identitetin e tyre nacional, etnik, kulturor, konfesional dhe gjuhësor si pjesë të traditës së tyre.

Në komunë me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit nacional apo etnik, pakicave dhe pjesëtarëve të tyre u mundësohet themelimi i institucioneve, shoqatave dhe organizatave joqeveritare në të gjitha lëmitë e jetës shoqërore.

Pjesëtarët e pakicave kanë të drejtë përcaktimi të pavarur dhe të lirë të identitetit nacional, të drejtën e zgjedhjes dhe të përdorimit të lirë të emrit personal dhe atij familjar dhe emrat e fëmijëve të vet, si dhe të drejtën e regjistrimit të atyre emrave në libat e amzës dhe në dokumenta personale në gjuhën dhe alfabetin e vet.

Neni 17

Në komunën e Ulqinit në përdorim zyrtar janë të barabarta gjuha malazeze dhe gjuha shqipe si dhe alfabetet e tyre.

Përdorimi zyrtar i gjuhës në kuptimin e paragrafit 1 të këtij neni nënkupton veçanërisht përdorimin e gjuhës në procedimet administrative dhe gjyqësore dhe në drejtimin e procedimeve administrative dhe gjyqësore, në dhënien e dokumentave publike dhe personale dhe mbajtjen e evidencave zyrtare në fletë votime dhe materialin tjetër zgjedhor dhe në punën e trupave të përfaqësimit.

Në komunën e Ulqinit emrat e organeve shtetërore dhe të organeve që kryejnë autorizime publike, emri i njësisë së vetqeverisjes lokale dhe të organeve administrative, emërtimet e vendeve të banuar, shesheve dhe rrugëve, institucioneve, të firmave afariste dhe firmave të tjera dhe të toponimeve shkruhen në gjuhën malazeze dhe shqipe.

Barazia e gjuhës malazeze dhe të gjuhës shqipe dhe alfabetit në jetën publike bëhet në procedim me institucionet publike, shkollat, ndërmarrjet dhe të gjitha subjektet që kryejnë autorizime publike në të gjitha përmbajtjet e jetës publike (mbledhje të qytetarëve, tubime, mbishkrimet e rrugëve dhe të shesheve, firmave, shpalljeve etj.)

Neni 18

Në Komunë në organet e udhëheqjes lokale, shërbimet publike, organet shtetërore dhe organet e vetqeverisjes lokale sigurohet përfaqësimi proporcional i pjestarëve të popujve, të popujve pakicë dhe grupeve etnike.

Pakicat kanë të drejtë në përfaqësimin proporcional në shërbimet publike, në organet e pushtetit shtetëror dhe të pushtetit vendor.

Për përfaqësimin e përfaqësuesëve të popujve pakicë kujdesen organet kompetente të qeverisjes lokale të ngarkuar me punë për çështje kadrovike në bashkëpunim me këshillat e pakicave.

Pakicat dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë të krijojnë dhe mbajnë marrëdhënie të lira dhe paqësore përtej kufiri me shtetet amë dhe me bashkëkombasit që jetojnë në shtete tjera, posaçërisht me ata me të cilët kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar, me atë që kjo e drejtë nuk mund të realizohet në kundërshtim me interesat e Malit të Zi.

Neni 19

Në kremtimet zyrtare shtetërore dhe kremtimet e komunës së Ulqinit me flamurin e Malit të Zi çohet dhe flamuri i popullit shqiptar në pajtim me ligjin.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E KOMUNËS DHE MËNYRA E REALIZIMIT TË TYRE

1. TË DREJTAT E KOMUNËS

Neni 20

Vetëqeverisja lokale realizohet në Komunë dhe përfshin të drejtën e qytetarëve dhe të organeve të vetqeverisjes lokale që, brënda kufijve të caktuar me ligj, rregullojnë dhe udhëheqin me punë të caktuara publike dhe të tjera, në bazë të përgjegjësisë personale dhe në interes të popullatës lokale, mbi parimet e demokracisë, të decentralizimit, depolitizimit, autonomisë, ligjshmërisë, profesionalizmit, efikasitetit në punën e organeve të vetëqeverisjes lokale dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë të shtetit dhe Komunës.

1.1. E DREJTA E BASHKIMIT

Neni 21

Komuna mund të bashkohet lirisht, në pajtueshmëri me ligjin.

Në kryerjen e punëve nga kompetencat e veta, Komuna mundet në principet e vullnetit dhe të solidaritetit në mënyrë të lirë të bashkëpunojë dhe të bashkojë mjetet me komuna të tjera për kryerjen e punëve me interes të përbashkët, me qëllim të plotësimit të nevojave të popullatës lokale, si dhe të bashkëpunojë lirshëm me bashkësitë lokale dhe asociacionet e shteteve të tjera, për realizimin e intereseve të përbashkëta dhe të bashkohet në organizatat regjionale dhe ndërkombëtare të pushteteve lokale.

2. DETYRAT E KOMUNËS

Neni 22

Komuna kryen punët e qeverisjes lokale të cilat janë me interes të të përbashkët dhe të drejtpërdrejte për popullatën lokale.

Neni 23

Komuna punët e veta i përcakton me Ligj dhe Statut, aktet e veta i rregullon me akte dhe siguron kushtet për realizimin e tyre.

Neni 24

Komuna kryen edhe punët që me rregullore i janë caktuar apo besuar nga ana e Qeverisë.

Për kryerjen e punëve të mbartura dhe të besuara nga paragrafi 1 të këtij neni mjetet sigurohen nga buxheti i Malit të Zi në pajtim me dispozitat mbi transferin gjegjësisht të besimit të atyre punëve.

PUNËT VETIAKE TË KOMUNËS

Neni 25

Komuna konforme Ligjit dhe dispozitave të tjera, bie:

1. Planet dhe programet zhvillimore;
2. Planet dhe programet e tokës ndertimore

3. Planin hapsinor – urbanistik dhe plane të tjera;
4. Buxhetin dhe llogarine përfundimtare të buxhetit;
5. Planin shumëvjeçarë investues ;
6. Dhe akte të tjera,në përputhje me kompetencat e veta

Neni 26

„Komuna në përputhje me ligjin dhe dispozitat e tjera :

- 1.Rregullon dhe siguron zhvillimin e veprimtarive komunale, mirëmbajtjen e objekteve dhe rendit komunal;
- 2.Rregullon dhe siguron zhvillimin e punëve ndërtimore,rikonstruimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve lokale dhe të pakategorizuara, si dhe rrugët në lagje;
- 3.Rregullon dhe siguron transportin e udhëtarëve në linjat urbane dhe periferike, transportin auto –taxi dhe transportin për nevojat individuale .
4. Rregullon dhe siguron zhvillimin e komunikacionit në territorin e vet;
5. Rregullon dhe siguron kushtet për ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve, si dhe kushtet për ndërtimin dhe vendosjen e objekteve ndihmëse dhe objekteve montazh me karakter të përkohshëm ;
6. Rregullon dhe siguron definimin e dedikimit të tokës ndërtimore në përputhje me dokumentat lokale planifikuese dhe paisjen komunale të tokës ndërtimore ,
7. Rregullon dhe siguron kushtet për zhvillimin e sipërmarrësve;
8. Rregullon, siguron dhe kujdeset për të mirat lokale të interesit të përgjithshëm ;
9. Siguron kushtet dhe kujdeset për mbrojtjen e mjedistit jetësorë dhe pjesë të saja të veçanta (kualiteti i ajrit,mbrojtja nga zhurma, administrimi i hedhjeve të ngurta etj.;
- 10.Rregullon dhe siguron kushtet për administrimin e ujrave,ujrat tokësorë dhe objektet ujore me rëndësi lokale, kujdeset për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e tyre, jep aktet ujore dhe udhëheq evidencën e përcaktuar me ligj,evidenton zonat erozive, masat kundëroerozive dhe aplikon mbrojtjen nga erozioni dhe rrebeshet; organizon dhe siguron zhvillimin e punëve të tjera nga fusha e administrimit,shfrytëzimit dhe mbrojtjen e ujrave dhe furnizimin me ujë;
11. Rregullon marrëdhëniet nga fusha e banimit dhe kujdeset për sigurimin e kushteve për mirëmbajtjen e ndërtesave banesore.
12. Rregullon, siguron dhe krijon kushte për zhvillimin e kulturës dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore ;
13. Rregullon, organizon, krijon kushte dhe kujdeset për zhvillimin e turizmit, si dhe zhvillimin e veprimtarisë me të cilat avansohet zhvillimi i turizmit .
14. Krijon kushte për zhvillimin dhe avansimin e sportit të fëmijëve, rinisë dhe qytetarëve, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkomunal në sport;
15. Krijon kushte për shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe kujdeset për mbrojtjen e saj ;
16. Në përputhje me mundësitë, merr pjesë në krijimin e kushteve dhe avansimin e veprimtarive:
-mbrojtjes shëndetësore ,arsimit ,mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, punësimin dhe fusha të tjera me interes për banorët lokal dhe kryen të drejtën dhe obligimet e themeluesit të institucioneve të cilat i themelon në këto veprimtari në përputhje me ligjin;
17. Në përputhje me mundësitë, rregullon dhe siguron zgjidhjen e nevojave banesore të personave me nevoja sociale dhe personave me nevoja të veçanta dhe ndihmon punën humanitare dhe organizatave joqeveritare nga kjo fushë;
18. Rregullon dhe siguron kushte për informimin e banorëve lokal ;
19. Rregullon dhe siguron kushte për zhvillimin e veprimtarisë bibliotekare dhe veprimtarive të tjera në interes të banorëve lokal;
20. Zgjidh të drejtat nga fusha e mbrojtjes luftëtaro-invalidore dhe mban evidencën rreth shfrytëzuesve të kësaj të drejte ;
21. Rregullon dhe siguron kushtet për mbrojtjen dhe shpëtimin e banorëve lokal nga fatkeqësitë elementare,zjarret, shpërthimet, avaritë dhe ndodhi të tjera aksidentale dhe të jashtëzakonshme;
22. Organizon dhe aplikon masat e mbrojtjes të banorëve nga sëmundjet infektuese;
23. Krijon kushtet për zhvillimin e prodhimve bujqësore (pemtari, kopshtari,ullishtari etj) dhe kryen të tjera punë nga kjo fushë;
24. Siguron kushtet për mbrojtjen e konsumatorit
25. Rregullon mënyrën dhe kushtet e mbajtjes së kafshëve shtëpiake,mënyrën e veprimit me kafshët endacake dhe ato të humbura,siguron kushtet për përkujdesin e tyre dhe aplikon masat e kontrollit të shumimit të tyre ;
26. Cakton orarin e punës në veprimtari të caktuara dhe cakton hapsirat në të cilat mund të zhvillohen veprimtari të caktuara ;
27. Rregullon dhe siguron kushtet për mbajtjen e panireve publike me rëndësi lokale,

28. Rregullon mënyrën e organizimit të punëve publike të rëndësisë lokale ;

Neni 27.

Në suazat e kompetencave të veta Komuna kryen edhe punët si vijojnë:

1. Drejton , disponon dhe mbron pasurine e saj dhe kryen disa te drejta pronësore ne pasurine shtetërore në përputhje me ligjin .
2. Drejton , vendos dhe vërteton lartësinë e të ardhurave vetanake në përputhje me ligjin;
3. Organizon dhe kryen punët ne caktimin e pagesave dhe kontrollit te mjeteve vetanake ;
4. Vendos për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve , personave juridik në punët nga kompetenca e saj .
5. Përcakton interesin e pergjithshëm per eksproprijimin e patundshmërive me rendesi lokale në përputhje me ligjin .
6. Mban listat zgjedhore dhe evidenca të tjera në përputhje me ligjin ;
7. Kryen punët e mbikqyrjes së inspektionit dhe punet e sigrimit të rendit komunal në përputhje me ligjin ;
8. Organizon dhe kryen punët e ofrimit te ndihmës juridike qytetarëve;
9. Themelon lëvdatat publike dhe çmimet
10. Kryen dhe punë të tjera në përputhje me nevojat dhe interesat e popullates lokale;

2.1. MËNYRA DHE KUSHTET E KRYERJES SË PUNËVE TË VETA

Neni 28

Mënyrën dhe kushtet e kryerjes së punëve të veta Komuna i kryen në përputhshmëri me mundësitë, interesat dhe nevojat e popullatës lokale.

Neni 29

Për të siguruar kryerjen e punëve me interes të drejtpërdrejte për popullatën lokale Komuna themelon:

1. organet e qeverisjes lokale
2. shërbimet publike

Organizimi i organeve të administratës lokale dhe shërbimeve nga Paragrafi 1 i këtij Neni rregullohet me vendime të veçanta.

3. Finansimi i Komunes

Neni 30

„Komuna siguron të ardhurat për kryerjen e punëve nga këto burime :

1. Tatimet lokale, taksat dhe kompenzimet të cilat komuna i vendos ne pajtim me ligjin .
2. „Tatimet e bartura për vjelje dhe kompenzimet në masën e vërtetuar me ligj të veçantë;
3. Subvencionet nga buxheti i Malit të Zi;
4. Burime të tjera në përputhshmëri me ligjin „

Neni 30 a

„ Komunës i sigurohen mjete për kryerjen e punëve te bartura dhe konfidencjale nga buxheti i Malit të Zi.

Mjetet e dedikuara të bartura nga buxheti shtetërorë duhet të mbahen të ndara nga mjetet e veta dhe mund të shfrytëzohen vetëm për qëllime që janë lejuar.

Neni 30 b

Para miratimit të Vendimit për buxhetin është e domosdoshme të merret mendimi i Ministrisë së Financave

Neni 31

Komuna ka buxhetin.

Për realizimin e buxhetit të komunës përgjegjës është Kryetari i komunës.

Mjetet për punën e organeve të qeverisjes lokale dhe të shërbimeve publike sigurohen në buxhetin e Komunës, në pajtim me ligjin dhe shfrytëzohen në pajtim me destinacion të caktuar.

Njësia konsumuese mjetet e lejuara i shfrytëzon sipas dinamikës të cilën e lejon Kryetari i Komunës.

Me mjetet e rezervës së buxhetit vijues disponon Kryetari i Komunës.

Vendimin për përdorimin e mjeteve të rezervës së përhershme buxhetore në raste të veçanta deri në 10% nga rezerva e përhershme buxhetore e bie këshilli kompetent me propozimin e Kryetarit të Komunës, ndërsa mbi këtë shumë vendimin e bie Kuvendi i komunës.

Për shfrytëzimin e mjeteve të buxhetit me dedikim përegjgjës është ekzekutuesi i buxhetit.

Neni 32

Komuna punët e veta financiare i kryen përmes llogarisë së konsoliduar të trezorit dhe librit kryesor të trezorit.

Punët e trezorit janë: planifikimi financiar, menaxhimi me para të gatshme, kontrolli i shpenzimeve, menaxhimi me borxhet, kontabiliteti buxhetor, raportimi dhe udhëheqja me sistemin financiar-informativ.

Komuna është e obliguar të paraqesë të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet si dhe marrjet e borxheve buxhetore, më së largëti në tremujorsh në afat prej 30 ditësh nga përfundimi i kuartalit, Ministrisë së financave.

Neni 33

Mbikëqyrjen mbi realizimin e buxhetit dhe shfrytëzimin e mjeteve me destinim të caktuar të cilat nga buxheti shpërndahen për qëllime të caktuara e bën Kuvendi.

Mbikëqyrja nga paragrafi 1 të këtij neni sigurohet duke i dorëzuar Kuvendit:

- Raportin gjashtëmujor mbi realizimin e buxhetit dhe të politikës investuese dhe
- Llogarinë përfundimtare të buxhetit.

Bashkangjitur me llogarinë përfundimtare të buxhetit të Komunës patjetër dorëzohet edhe raporti i revizionit të jashtëm.

Kuvendi mundet me propozimin e Kryetarit të Kuvendit ose 1/3 e këshilltarëve me argumentimin gjegjës edhe para afatit të caktuar me paragrafin 2 të këtij neni të kërkojë dorëzimin e raportit mbi realizimin dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore nga ana e shfrytëzuesit të mjeteve buxhetore.

Neni 34

Mbikëqyrjen mbi punët financiare, materiale dhe kontabiliste të shfrytëzuesëve të buxhetit në pikëpamjen e dedikimit, vëllimit dhe dinamikës së shfrytëzimit të mjeteve e bën Kryetari i Komunës.

Mbikëqyrjen nga paragrafi 1 të këtij neni bëhet me paraqitjen e Raportit nga ana e shfrytëzuesëve të mjeteve buxhetore si dhe, me njohjen e drejtpërdrejtë të zyrtarit të autorizuar tek shfrytëzuesit e mjeteve buxhetore dhe paraqitjen e raporteve periodike të shfrytëzuesëve të buxhetit Kryetarit të Komunës.

Neni 35

Mbikëqyrjen mbi punët financiare, materiale dhe kontabiliste të shërbimit publik e bën Kuvendi.

Mbikëqyrjen nga paragrafi 1 të këtij neni bëhet me paraqitjen e raportit vjetor financiar të Kuvendit të komunës.

4. PASURIA E KOMUNËS

Neni 36

Pasurinë e Komunës e përbëjnë sendet mobilare dhe imobilare mjetet financiare, letrat me vlerë dhe të drejtat e tjera pronësore në pajtim me ligjin.

Me pasurinë e Komunës posedon dhe udhëheq Kuvendi.

Komuna kemben dhe udhëheq me pasurinë e vet, sipas dedikimit, në pajtim me Ligjin dhe praktikës së mirë të menaxhmentit ekonomik dhe financiar.

Neni 37

Komuna dhe shërbimet publike janë të detyruara të mbajnë evidencën mbi pasurinë e vet, në pajtim me Ligjin.

Organi udhëheqës i Komunës, kompetent për punët e pasurisë, së paku një herë në vit i paraqet Kuvendit raportin mbi gjendjen e pasurisë.

III. ORGANIZIMI DHE MENYRA E PUNES

1. ORGANET E KOMUNËS

Neni 38

Organet e Komunës janë:

- Kuvendi i Komunës (në tekstin në vijim Kuvendi) dhe
- Kryetari i Komunës.

KUVENDI

Neni 39

Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve i cili kryen funksionin në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe këtë Statut.

Kuvendin e përbëjnë këshilltarët të cilët i zgjedhin qytetarët në periudhën prej 4 viteve, në pajtim me ligjin. Numri i këshilltarëve në Kuvendin e Komunës përcaktohet me vendim të veçantë.

Neni 39 a

„Zgjedhjet për Kuvendin i shpall Presidenti i Shtetit „

Zgjedhjet nga paragrafi 1 i këtij neni mbahen me se voni 15 ditë para skadimit të mandatit të Kuvendit .

Në rast se zgjedhjet nuk shpallen në përputhje me ligjin, zgjedhjet i shpall Qeveria .

Qytetarët zgjedhin këshilltarët për Kuvendin ne bazë të të drejtës së lirë të përgjithshme zgjedhore , në përputhje me ligjin .

Neni 40

Mbledhja e parë e Kuvendit të sapozgjedhur thirret në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

Mbledhjen e Kuvendit nga paragrafi 1 i këtij Neni e thërret Kryetari i Kuvendit nga përbërja e vjetër .Nese mbledhja e Kuvendit nuk thirret ne afat nga paragrafi 1 i këtij Neni , mbledhjen e thërret Qeveria .

Mbledhjen e kryeson këshilltari më i vjetër deri në zgjedhjen e kryetarit të kuvendit .

Neni 41

Mandati i këshilltarëve fillon të rrjelle nga dita e verifikimit të mandateve nga ana e Kuvendit.

Verifikimi i mandateve është kryer kur Kuvendi të jetë njohur me Raportin e Komisionit zgjedhor komunal.

Për raportin e Komisionit komunal zgjedhorë Kuvendi nuk voton

1.2. PUNËT E KUVENDIT

Neni 42

Kuvendi:

1. aprovon Statutin e Komunës dhe vendos mbi ndryshimet dhe plotësimet e tij
2. bie dispozitat dhe aktet e tjera të përgjithëshme
3. bie planet dhe programet e zhvillimit të komunës
4. bie dokumentat e planeve lokale
5. bie Programin për rregullimin hapsinorë
6. bie Buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit
7. bie Planin e përmirësimeve kapitale dhe përcakton politikën investuese
8. përcakton lartësinë e tatimeve, taksave dhe kompenzimeve komunale
9. disponon dhe udhëheq me pasurinë e Komunës
10. përcakton kushtet për themelimin e bashkësive lokale dhe jep pëlqimin në vendimet për themelimin e bashkësive

lokale

11. shpall referendumin për territorin e komunës ose për një pjesë të territorit

12. vendos për iniciativën qytetare

13. vendos për shpalljen e vetkontributit për territorin e Komunës
14. themelon shërbimet publike, organizatën turistike të qytetit
15. vendos për borxhmarrje dhe dhënien e garancionit në pajtim me ligjin
16. bën verifikimin e mandateve dhe vendos për të drejtat e këshilltarëve
17. zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Kuvendit, Kryetarin e Komunës , emëron sekretarin dhe anëtarët e trupave punuese dhe këshilldhënës
18. paraqet propozimin për vlerësimin e kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë së akteve shtetërore dhe organeve të tjera, kur vlerëson se është shkelur e drejta në vetëqeverisjen lokale
19. shqyrton raportin e Kryetarit të komunës mbi punën e tij dhe punën e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve të cilin ky e paraqet një herë në vit
20. aprovon Rregulloren e punës së Kuvendit
21. bie kodin etik
22. jep shpjegime autentike të dispozitave që miraton
23. bie Vendimin mbi shpalljen e zgjedhjeve për Kryetarin e Komunës
24. bie Vendimin për krijimin e komiteteve, këshilleve dhe komisioneve dhe mbi besueshmërinë e punëve të veta këshilleve
25. bie Programin e punës së Kuvendit të komunës
26. bie Vendimin mbi dhënien e konçesioneve për të mirat natyrore të cilat janë në kompetencat e Komunës në pajtim me ligjin
27. përcakton kushtet e përgjithëshme për rregullimin e vendbanimeve në territorin e Komunës, shfrytëzimin e sipërfaqeve publike dhe të tjera
28. përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies në shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore komunale dhe bie Programin e shfrytëzimit të përkohshëm të tokës komunale
29. bie Vendimin mbi themelimin apo anëtarësimin në asociacionet e komunave për territorin e Shtetit dhe bashkësitë ndërkomunale
30. bie Vendimin mbi bashkëpunimin dhe bashkimin me bashkësitë lokale dhe asociacionet e shteteve të tjera
31. bie Vendimin mbi themelimin dhe ndarjen e shpërblimeve dhe mirënjohjeve publike dhe dhënien e titullit të qytetarit të nderit dhe shtëpiakut të mirë
32. bie Vendimin mbi punimin , përdorimin, ruajtjen dhe asgjësimin e vulës
33. bie Vendimin mbi përdorimin e simboleve
34. përcakton mënyrën dhe procedurën e pjesëmarrjes së qytetarëve në kryerjen e punëve publike
35. përcakton zonat dhe emrat e vendbanimeve, rrugëve dhe shesheve
36. bie Vendimin mbi policinë komunale
37. bie Vendimin mbi numrin e këshilltarëve
38. emron dhe shkarkon organet udhëheqës , këshillat e kontrollit dhe organet udhëheqëse në shërbimet publike, gjegjësisht jep pëlqimin për emërimin dhe shkarkimin e organeve udhëheqëse të shërbimeve publike themelues i të cilëve është Komuna
39. jep pëlqimin për statutet e shërbimeve publike, për ndryshimet statutore, rritjen dhe zbritjen e kapitalit shoqëror (kryegjësë), për Planin zhvillimor, Programin e punës dhe aktet e tjera programore të shërbimeve publike
40. siguron zbatimin e interesit publik në shërbimet publike themeluese e të cilave është Komuna
41. bie Planin për mbrojtjen nga zjarret dhe fatkeqësitë e tjera elementare
42. bie Vendimin mbi kompenzimin për punën e këshilltarëve
43. bie vendimin për themelimin e fletës zyrtare të komunës
44. nis iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera
45. bie vendimet me të cilat rregullohen çështjet e realizimit të të drejtave dhe detyrave të këshilltarëve dhe funksionerëve që i zgjedh Kuvendi
46. bie vendimin mbi nisjen e procedurës së interpelancës
47. bie vendimin mbi nisjen e hetimeve nga ana e Kuvendit
48. bie vendimin mbi nisjen për parashtrimin e hetimeve kontrolluese dhe konsultative
49. bën dhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut.

1.3. AKTET E KUVENDIT

Neni 43

Në kryerjen e punëve nga fushëveprimi i vet, përveç Statutit, Kuvendi bie edhe vendimet, aktvendime dhe akte tjera:

- me vendime vendoset për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve, themelohen shërbimet publike dhe vendoset për çështjet e tjera konforme ligjit dhe Statutit të Komunës;
 - me aktvendime vendoset për çështjet vetanake konforme ligjit dhe dispozitave të tjera;
 - përfundimet mbi çështjet e veçanta me rëndësi për përforcimin dhe udhëheqjen e politikës;
 - dokumentat dhe rekomandimet në të cilat pasqyron qëndrimin e vet në raport me çështjet e veçanta sistemore nga kompetencat e veta, gjegjësisht çështjeve që kanë të bëjnë me organet tjera dhe shërbimet publike.
- Kuvendi mund të miratojë edhe akte të tjera nga kompetencat e veta.

Neni 44

Vendimet dhe aktet e tjera të përgjithëshme të Kuvendit hyjnë në fuqi tetë ditë pas shpalljes në „Fletën zyrtare të MZ – dispozitat komunale“.

Në raste të jashtëzakonshme, kur për këtë ekzistojnë shkaqe të përcaktuara gjatë procedimin të miratimit, mund të parashihet që vendimi dhe aktet tjera të përgjithëshme të fuqizohet më së largëti në ditën e shpalljes.

1.4. MËNYRA E THIRRJES DHE VENDIMARRJET E KUVENDIT

Neni 45

Kuvendin e thërret Kryetari i Kuvendit sipas nevoje, më së paku një herë në tre muaj.

Kryetari thërret Kuvendin, me iniciativën e vet, me kërkesën e Kryetarit të Komunës, 1/3 së këshilltarëve ose me iniciativën e më së paku 5% të qytetarëve nga numri i regjistruar në regjistrin zgjedhor të Komunës nga zgjedhjet e fundit të realizuara, në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës gjegjësisht iniciativës.

Në rastin e paragrafit 3 të këtij neni me Kuvend udhëheq këshilltari të cilin e cakton parashtruesi i kërkesës, gjegjësisht iniciativës.

Neni 46

Iniciativa, gjegjësisht kërkesa për paragrafin 2 të nenit pararendës, patjetër përmban çështjen që duhet shqyrtuar dhe shkakun për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit.

Iniciativa e qytetarëve nga paragrafi 2 të nenit pararendës patjetër përmban edhe të dhënat mbi numrin i veçantë i amzës së qytetarit ose numrin e regjistrimit të letërnjoftimit dhe nënshkrimi personal i qytetarit.

Neni 47

Të drejtën e propozimit të vendimeve, të dispozitave tjera dhe akteve të përgjithëshme ka Kryetari i Komunës, këshilltari ose së paku 5% e qytetarëve, nga numri i të regjistruarëve në regjistrin zgjedhor të Komunës, nga zgjedhjet e fundit të realizuara.

Kuvendi mund të vendose, me shumicën e votave të këshilltarëve prezent, nëqoftëse me ligj apo Statut për çështje të veçanta nuk është paraparë ndonjë shumicë tjetër.

Mënyra e punës dhe vendimmarrjes së Kuvendit më detajisht përcaktohet me Rregulloren e Punës.

Neni 48

Kuvendi vendos me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve mbi:

- miratimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit;
- borxhmarrjen dhe dhënien e garancioneve të Komunës;
- shpalljen e referendumit;
- iniciativën për inicimin e procedurës për mosbesimin e Kryetarit të Komunës;
- zgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit dhe emërimin e Sekretarit të Kuvendit;
- zgjedhja e Këshillit për mbrojtjen e vetqeverisjes lokale;
- propozimin për Vendimin mbi vetkontributin;
- propozimin e akteve për rregullimin e çështjes që është lëndë e iniciativës qytetare dhe
- formën dhe mënyrën e deklarimit të drejtpërdrejt të qytetarëve.

1.5. TË DREJTAT DHE DETYRAT E KËSHILLTARËVE

Neni 49

Këshilltari nuk mund të thirret në përgjegjësi penale, të paraburgoset apo dënohet për mendimin e shprehur ose votimin në Kuvend.

Neni 50

Këshilltari ka të drejtë dhe detyrë që:

- të marrë pjesë në punën e Kuvendit dhe tupat e tij punuese
- t'i propozojë Kuvendit shqyrtimin e çështjeve të caktuara nga kompetencat e tij, paraqet propozimin për prurjen e vendimeve dhe të akteve tjera dhe të amandamenteve në propozimet e vendimeve
- nga pozita e këshilltarit t'i bëjë pyetje Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës, organeve të qeverisjes lokale dhe shërbimeve publike
- të ruajë mëshfhtësinë dhe të dhënat tjera të natyrës sekrete dhe për këtë mban përgjegjësi
- këshilltari që është në konflikt interesi është i obliguar që menjëherë të japë dorëheqjen
- të kryejë edhe punë të tjera në pajtim me ligjin, me këtë Statut dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Neni 51

Këshilltari nuk mund të jetë shef i organit të qeverisjes lokale si dhe as zyrtar dhe nëpunës i punësuar në qeverisjen lokale.

Neni 52

Kryetari i Kuvendit, kryetari i trupit punues të Kuvendit, Sekretari i Kuvendit dhe organi kompetent i qeverisjes lokale për punët e Kuvendit sigurojnë kushtet për nevojat e ushtrimit të funksionit të këshilltarit dhe kjo:

- ofrojnë ndihmë në përpilimin e propozimeve të cilat ia paraqet Kuvendit dhe trupit punues dhe ndihmon në kryerjen e punëve të tjera të cilat ia beson trupi punues apo Kuvendi;
- siguron shfrytëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për çështjet nga veprimtaria i punës së Kuvendit dhe trupit punues dhe
- japin sqarime profesionale mbi pyetjet nga veprimtaria e Kuvendit, organeve të qeverisjes lokale dhe shërbimeve.

Neni 53

Këshilltarëve u jepen letërnjoftimet e këshilltarëve përmbajtjen dhe formën e të cilave e përcakton Kuvendi i komunës.

Sekretari i Kuvendit kujdeset për dhënien dhe evidentimin e letërnjoftimeve të lëshuara të këshilltarëve

Neni 54

Këshilltari ka të drejtë që në mbledhje të Kuvendit të bëjë më së shumti dy pyetje, ndërsa përgjegjet jepen me gojë ose me shkrim me thirrjen për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, nëse këshilltari këtë kategorikisht e kërkon.

Këshilltari ka të drejtë për kompenzimin për punë, mëditje, shpenzimet e udhëtimit e tjera në pajtim me vendimet e Kuvendit.

Për të realizuar funksionin e vet, këshilltari ka të drejtë për ndihmë profesionale dhe informacione të nevojshme mbi çështjet nga rrethveprimi i organeve të qeverisjes lokale dhe të shërbimeve profesionale.

Neni 55

Këshilltari i jep dorëheqjen Kryetarit të Kuvendit në formë të shkruar.

Kryetari i Kuvendit dorëheqjen iu dorëzon këshilltarëve dhe Komisionit zgjedhor të komunës.

Kuvendi në mbledhjen e parë vijuese konstaton pushimin e mandatit të këshilltarit në rastin e dhënies sërheqjes, si dhe në rastet e tjera të parapara me ligj.

1.6. KLUBET E KËSHILLTARËVE

Neni 56

Në Kuvend themelohen iKlubet e këshilltarëve.

Klubin e këshilltarëve e përbëjnë së paku dy këshilltarë.

Këshilltari mund të jetë anëtar vetëm i një klubi të këshilltarëve.

Konstituimi i klubit të këshilltarëve bëhet duke i dorëzuar Kryetarit të Kuvendit listën e anëtarëve të klubit dhe të kryetarit të zgjedhur nga klubi.

Lista përmban emrat dhe nënshkrimet e kryetarit dhe të anëtarëve të klubit.

1.7. TRUPAT PUNUESE

Neni 57

Për kryerjen efikase dhe racionale të punëve nga kompetencat e veta, Kuvendi themelon këshillat dhe bordet si trupa të përhershme punuese, ndërsa mund të themelojë edhe komisionet si trupa punuese të përkohshëm.

Neni 58

Për anëtarë të këshillave Kuvendi emëron këshilltarët e Kuvendit.

Përbërja e këshillave duhet t'i përgjigjet strukturës së Kuvendit.

Për anëtarë të këshillave dhe komisioneve, përveç këshilltarëve, mund të emërohen punëtorë shkencorë dhe profesional dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, në mënyrë që numri i tyre nuk mund të jetë më i madh se gjysma e numrit të përgjithshëm i anëtarëve të trupave punuese.

Neni 59

Trupat e përhershme punuese shqyrtojnë propozim vendimet, aktet e tjera, si dhe çështje të tjera që janë në rend dite të Kuvendit dhe për to japin mendimet dhe propozimet.

Kuvendi mund t'u besojë këshillave vendimmarrjen për çështje të caktuara në pajtim me ligjin.

Neni 60

Trupat e përkohshme punuese themelohen me vendim të veçantë, me të cilin përcaktohet fushëveprimi dhe mënyra e punës së tyre, përbërja dhe afati për të cilin themelohen.

Neni 61

Kryetari i Këshillit, gjegjësisht komisioni emërohet nga radhët e këshilltarëve.

Neni 62

Trupi punues ka kryetarin dhe numrin e caktuar të anëtarëve.

Këshilltari mund të jetë anëtar i një ose më shumë trupave punues.

Neni 63

Kuvendi themelon këshillat për:

1. statutin dhe dispozitat;
2. zgjedhje dhe emërime;
3. finansa dhe ekonomi;
4. planifikimin dhe rregullimin e hapësirës dhe veprimtarinë komunale-banesore;
5. veprimtaritë shoqërore, lutjet dhe ankesat;
6. bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkombëtar si dhe bashkëpunimin me diasporën dhe
7. barazinë gjinore.

Neni 64

Kuvendi themelon këshillat për:

1. Mbrojtjen e mjedisit jetësor;
2. dhënien e propozimeve për emërtimin e vendbanimeve, rrugëve, shesheve dhe institucioneve;
3. përmirësimin e pozitës së invalidëve dhe të personave të hendikepuar etj.

Neni 65

Kuvendi me vendim të posaçëm mund të formojë edhe trupa tjera punuese.

Neni 66

Anëtarët e trupave punuese të Kuvendit kanë të drejtë kompenzimi për punën e vet.

1.8. KRYETARI I KUVENDIT

Neni 67

Kuvendi ka Kryetarin.

Kryetari i Kuvendit zgjidhet me propozimin e 1/3 së këshilltarëve. Kuvendi nga radhët e këshilltarëve, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Mandati i kryetarit të Kuvendit zgjat aq sa edhe mandati i Kuvendit.

Neni 68

Funkcioni i Kryetarit të Kuvendit, sipas rregullave është vullontër.
Kuvendi mund të vendose që Kryetari i Kuvendit funksionin ta kryej profesionalisht.

Neni 69

Kryetari i Kuvendit thërret Kuvendin, kryeson dhe udhëheq me punën e tij dhe kujdeset për realizimin e vendimeve të tij dhe të akteve tjera.
Në rast të mungesës apo pengesës së Kryetarit, me Kuvend udhëheq këshilltari të cilin e cakton Kryetari i Kuvendit.

Neni 70

Kryetari i Kuvendit mund të shkarkohet para afatit kohor për të cilën është zgjedhur me dhënien e dorëheqjes Kuvendit, me mosdhënien e votbesimit nga ana e Kuvendit ose me fuqinë e ligjit.

Neni 71

Kuvendi konstaton dhënien e dorëheqjes së Kryetarit të Kuvendit në mbledhjen e pare vijuese, me çrast Kryetari i Kuvendit pushohet nga funksioni.

Neni 72

Veprimi i votimit për mosbesimin e Kryetarit të Kuvendit sillet nëse:
- nuk i kryen punët në pajtim me ligjin, me këtë Statut dhe akte të tjera;
- keqpërdoron funksionin e vet.

Neni 73

Kryetari i Kuvendit mundet në Kuvend të bëjë pyetje të besueshmërisë së tij.
Propozimin për votëbesimin e Kryetarit të Kuvendit mund ta paraqesin 1/3 e këshilltarëve.
Kryetari i Kuvendit ka të drejtë që në mbledhje të sqarohen mbi shkaqet e votimit për mosbesim.
Vendimin për votimin e mosbesimit Kuvendi e bie me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.
Çështja e përsëritjes së besueshmërisë nuk mund të vëhet në rend dite një vit nga dita e votimit të mosbesimit.

Neni 74

Dispozitat ligjore mbi ndërprerjen e mandatit sipas fuqisë së ligjit, që kanë të bëjnë me Kryetarin e Komunës, vlejne edhe për Kryetarin e Kuvendit.

1.9. SEKRETARI I KUVENDIT

Neni 75

Kuvendi ka Sekretarin i cili kujdeset për kryerjen e punëve profesionale në lidhje me thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe trupave punuese të tij, e sidomos: -

- përgatitja e mbledhjes së Kuvendit dhe të trupave punuese të tij;
- koordinon me aktivitetet e organeve të qeverisjes lokale në përgatitjen e mbledhjes;
- organizon dhe udhëheq me Shërbimin për punët e Kuvendit;
- kujdeset për kryerjen e punëve profesionale dhe punëve të tjera në lidhje me thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe të trupave punuese të tij;
- përcjell realizimin e vendimeve të prura dhe të akteve të tjera të Kuvendit;
- është përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit, të stenogramit, vendimeve dhe akteve tjera të përgjithëshme të Kuvendit dhe distribuimin e tyre;
- është përgjegjës për shpalljen e vendimeve dhe të akteve të tjera të përgjithëshme të Kuvendit;
- ndihmon Kryetarin e Kuvendit në punë dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me Statut dhe me akte të tjera.

Neni 76

Sekretarin e Kuvendit e emëron dhe shkarkon Kuvendi, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Për Sekretar mund të emërohet individ që ka kryer fakultetin juridik , ka dhënë provimin profesional për punë në organet shtetërore dhe së paku 5 vjet përvojë pune.

Mandati i sekretarit të Kuvendit zgjat sa edhe mandati i Kuvendit.

Neni 77

Sekretari për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Kuvendit dhe Kuvendit.

Sekretari i Kuvendit mund të shkarkohet para përfundimit të mandatit për të cilin është emëruar me shkarkimin nga ana e Kuvendit, me shpërbërjen e Kuvendit, me kërkesën personale dhe në raste të tjera të parapara me ligj.

Sekretari i Kuvendit mund të shkarkohet nëqoftëse punët nga fushëveprimi i tij nuk i kryen në mënyrë ligjore dhe efikase.

Sekretari i Kuvendit ka të drejtë që në mbledhjen e Kuvendit të sqarohet rreth shkaqeve të shkarkimit.

Neni 78

Propozimin për shkarkimin e Sekretarit të Kuvendit mund ta paraqesin Kryetari i Kuvendit ose 1/3 e këshilltarëve.

Procedimin për shkarkimin e sekretarit të Kuvendit e fillon Kryetari i Kuvendit.

Për të vërtetuar ekzistimin e shkaqeve për shkarkim Kuvendi emëron komisionin.

1.10. TRANSPARENCA E PUNËS SË KUVENDIT

Neni 79

Puna e Kuvendit është publike

Kuvendi dhe trupat punuese të tij do të punojë me dyer të mbyllura në raste kur shqyrtohen materiale të cilat janë shënuar si rezervate.

Neni 80

Konferencën për shtyp në Kuvend mund ta mbaj Kryetari dhe sekretari i Kuvendit, kryetari i klubit të këshilltarëve ose këshilltari i autorizuar, kryetari i trupit punues të Kuvendit ose anëtar i cilin ai e autorizon.

2. KRYETARI I KOMUNËS

Neni 81

Kryetari i Komunës është organ ekzekutiv i Komunës

Kryetarin e Komunës e zgjedh Kuvendi, me shumicë votash nga numri I përgjithshëm I këshilltarëve.

Kryetari zgjidhet me afat 4-vjeçar, me mundësi që funksionin ta kryej më së shumti në dy mandate.

Neni 82

1. Funkzioni I Kryetarit të Komunës është profesional
2. Nga aspekti I kushteve për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet zgjedhja e këshillatrëve dhe deputetëve.
3. Kryetarit të Komunës I cili është zgjedhur nga rradhët e këshilltarëve , me emrimin ne funksionin e Kryetarit të Komunës I pushon mandate I këshilltarit .
4. Me marrjen e detyrës Kryetari i Komunës jep deklaratën solemne përpara Kuvendit. Teksti i deklaratës solemne është:
5. “Deklaroj se detyrën e Kryetarit të Komunës do ta kryej në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe Statutin e Komunës”.

Neni 82 a

1. Kandidatin për Kryetar të Komunës mund t’a propozojnë më se pakti ¼ e këshilltarëve në Kuvend . Propozimi përmbanë emrin dhe mbiemrin e kandidatit, biografinë e shkurtër dhe aresyetimin e kandidatures,si dhe pëlqimin e kandidatit për kandidature në formë të shkruar. Propozimi I kandidatit për Kryetar të Komunës I dërgohet Kryetarit të Kuvendit në formë të shkruar . Kryetari I Kuvendit ia paraqet këshilltareve të gjitha propozimet e mbërritura të kandidatëve për Kryetar të Komunës. Për kandidatët e propozuar hapet debat.

Neni 82 b

Nese ka më shumë kandidatë të propzuar, Kryetari I Kuvendit vërteton listen e kandidatëve. Renditja në listën e kandidatëve vërtetohet sipas numrit të nënshkrimeve të këshilltarëve të cilët kane përkrahur kandidatët e caktuar.

Neni 82 v

Kryetari I Komunës zgjidhet me votim të hapur .

Nëse për Kryetarë janë propzuar më shumë kandidate zgjedhja bëhet me votim të fshehtë.

Me votimin e fshehtë për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës udhëheq Kryetari I Kuvendit, të cilit në punë

I ndihmon sekretari I kuvendit dhe dy këshilltarë që Kuvendi, në propozim të Kryetarit të Kuvendit , zgjedh nga të cilët njëri përfaqësues është nga rradhët e partive opozitare.

Këshilltarët nga paragrafi 3 I këtij neni nuk mund të jenë kandidate për Kryetarë.

Votimi I fshehtë bëhet me fletë votimi.

Në fletë-votimin e kandidatët veçohen me renditje të vërtetuar në listen e kandidatëve .

Para emrit të sejcilit kandidat vendoset numri rendor .

Fletët e votimit janë të të njëjtës madhësi, formë dhe ngjyrë dhe në sejcilen është e vendosur vula e Kuvendit .

Neni 82 g

Sejcili këshilltarë pas thirrjes, merr fletën e votimit .

Pasi të jetë vërtetuar që këshilltarët kane marrë fletët e votimit, Kryetari I Kuvendit jep njoftimet rreth mënyrës së votimit dhe cakton kohën e votimit .

Këshilltari voton për njërin nga kandidatët, duke rrumbullaksuar numrin rendorë para emrit të kandidatit për të cilin voton .

Këshilltari vetë vendos fletë-votimin e palosur në kutinë e votimit.

Neni 82 d

Me përfundimin e votimit fillon procesi I vërtetimit të rezultateve të votimit.

Rezultatet e votimit vërtetohen në bazë të fletë-votimeve të dorëzuara.

Kryetari I Kuvendit publikon sa këshilltarë kanë marr fletë- votimet,sa këshilltarë kanë votuar,sa fletë-votime janë të pavlefshme, sa vota ka marrë sejcili kandidat dhe cili kandidat është zgjedhur për Kryetarë të Komunës .

Neni 82 gj

Fletë votimi konsiderohet I pavlefshëm nëse: fletë votimi është I paplotësuar,lista në të cilin është rrumbullaksuar numri rendorë para emrit te disa kandidatëve ose fletë-votimi I cili është plotësuar në mënyrë që nuk mund të vërtetohet për cilin ka votuar këshilltari .

Neni 82 e

Nëse asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e duhur për Kryetarë të Komunës, votimi përsëritet ndermjet dy kandidatëve të cilët kane fituar numrin më të madh të votave.

Nëse as në votimin e përsëritur nuk zgjidhet Kryetari I Komunës procesi I votimit përsëritet .

Në këtë proces propozohen kandidatë të rinj.

Neni 82 zh

Për Kryetarë të Komunës është zgjedhur kandidati, I cili ka fituar numrin me të madh të votave nga nurmi I përgjithshëm I këshilltarëve në Kuvend.

2.1. PUNËT E KRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 83

Kryetari i Komunës:

1. Prezenton dhe përfaqëson Komunën;
2. propozon dispozitat dhe aktet e tjera të cilat i bie Kuvendi, si dhe mënyrën e shqyrtimit të çështjeve të veçanta nga kompetencat e Komunës;
3. kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e ligjit, të dispozitave tjera dhe akteve të përgjithshme si dhe për aplikimin edokumenteve strategjik me rëndësi shtetërore ;
4. kujdeset dhe është përgjegjës për kryerjen e punëve të bartura dhe të besuara;
5. konsolidon organizimin dhe mënyrën e punës së qeverisjes lokale me marrjen e mendimit të kryeadministratorit;
6. emëron dhe shkarkon nënkryetarin e Komunës dhe kryeadministratorin, me pëlqimin e Kuvendit;
7. jep pëlqimin në aktet mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimit të organeve të qeverisjes lokale, të shërbimeve profesionale dhe shërbimeve të tjera;
8. emëron dhe shkarkon drejtorët e agjensive, që i themelon;
9. emëron dhe shkarkon menaxherët;
10. jep pëlqimin për emërimin dhe shkarkimin e udhëheqësve të organeve të administratës lokale;
11. shtron përpara Kuvendit raportin mbi punën e vet dhe realizimin e funksionit të administratës lokale, së paku një here në vit;
12. drejton dhe koordinon punën e organeve të administratës lokale, të shërbimeve publike dhe agjensive themelues i të cilave është, për realizimin sa më efikas të funksioneve dhe ofrimit të shërbimeve publike sa më kualitative, për të cilat bie aktet përkatëse;
13. bën mbikëqyrjen mbi punën e organeve të administratës lokale;
14. bie akte nga kompetencat e veta dhe akte për kryerjen e punëve të mbartura dhe të besuara, nëqoftëse kjo nuk është rregulluar ndryshe me dispozita të veçanta;
15. është përgjegjës për zbatimin e vendimeve dhe të akteve të tjera që i bie Kuvendi dhe bie akte për realizimin e tyre;
16. bie vendimin mbi investimet në pajtim me politikën investuese të caktuar;
17. jep mendimin mbi propozim vendimet dhe aktet e tjera të cilat Kuvendit ia paraqesin propozuesit e tjerë;
18. zgjidh konfliktin e kompetencave në mes të organeve të administratës lokale, shërbimeve publike dhe të personave juridik të cilëve me vendimin e Kuvendit u është besuar kryerja e punëve të caktuara;
19. vendos për marrjen e kompetences e kryeadministratorit, me pëlqimin e Kuvendit
20. përcakton direktivat për realizimin e planeve dhe programeve të zhvillimit për veprimtari të caktuara;
21. përcjell realizimin e politikës punuese të shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna dhe propozon gjegjësisht merr masa për të siguruar kushtet për funksionimin e tyre;
22. jep pëlqimin në aktet me të cilat përcaktohet numri dhe struktura e të punësuarve në shërbimet publike të cilat finansohen nga buxheti I Komunës;
23. bie vendimin mbi dedikimin me mjetet e rezervave të buxhetit vijues në pajtim me ligjin dhe vendimin e Kuvendit të Komunës;
24. paraqet para Kuvendit Raportin mbi punën e organeve të administratës lokale së paku një here në vit;
25. jep pëlqimin për aktet mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, dhe të agjensive që I themelon;
26. kryen edhe punë të tjera në pajtim me ligjin, Statutin dhe vendimet e Kuvendit.

Neni 84

Për punët nga kompetencat e veta , Kryetari i jep përgjegjësi Kuvendit.

Për kryerjen e punëve të mbartura dhe të besuara Kryetari i jep përgjegjësi Qeverisë.

Në rast të të kryerjes apo moskryerjes joligjore të punëve të mbartura dhe të besuara, Qeveria lajmëron Kuvendin dhe propozon marrjen e masave.

Nëqoftëse nuk merren masa nga paragrafi 3 të këtij neni Qeveria do të paralajmërojë Kuvendin për pasojat e mosmarrjes së masave dhe do ndër marrë aktivitetet e tjera në pajtim me kompetencat e veta.

2.2. AKTET E KRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 85

Në kryerjen e punëve të parapara me ligj dhe me këtë Statut, Kryetari i Komunës bie vendimet udhëzimet, rregulloret, urdhëresat, aktvendimet dhe përfundimet.

- me vendime përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së organeve të administratës lokale dhe rregullohen disa çështje të veçanta në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj apo dispozita të tjera;
- me udhëzim përcaktohet mënyra e veprimit dhe e kryerjes së punëve të organeve të administratës lokale dhe subjekteve të tjera që kryejnë punë me interes të Komunës për realizimin e ligjit, vendimeve të Kuvendit të komunës dhe të dispozitave të tjera;
- me rregullore përpunohen më detajisht çështje të veçanta që janë të rregulluara me ligj, vendimin e Kuvendit të komunës dhe dispozita të tjera;
- urdhëresa sillet me qëllim të zgjidhjes së situatave të veçanta konkrete me rëndësi të përgjithshme në raste kur është e paraparë me ligj apo me dispozita të tjera;
- me aktvendim vendoset për themelimin e këshillave profesionale dhe komisioneve, jepet pëlqimi për aktet që i bien organet e administratës lokale dhe subjektet e tjera të cilat kryejnë punë me interes publik dhe në raste të tjera në pajtim me ligjin;
- me përfundim caktohen detyrat e organeve të administratës lokale dhe të subjekteve të cilat kryejnë punë me interes publik, merren qëndrime, vendoset për lejimin e mjeteve nga buxheti i Komunës dhe për çështje të tjera nga kompetencat e kryetarit për të cilat nuk vendoset me akte të tjera.

Neni 86

Kryetari i Komunës, përkohësisht bie aktet nga kompetencat e Kuvendit, nëqoftëse Kuvendi nuk ka mundësi për t'u takuar ose për shkaqe tjera pengohet puna e tij, ndërsa me mosprurjen e tyre do të rrezikohet jeta e qytetarëve ose të pasurisë me vlera të mëdha.

Kryetari është i detyruar që aktet nga paragrafi 1 të këtij neni t'i paraqesë për miratim Kuvendit në mbledhjen e parë paraprake.

Nëqoftëse Kuvendi nuk i miraton aktet nga paragrafi 1 të këtij neni ose kryetari nuk e paraqet për miratim, ky akt pushon të jetë i vlefshëm në ditën e përfundimit të Kuvendit.

2.3. NDËRPRERJA E MANDATIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS

Neni 87

Kryetarit të Komunës i ndërpritet mandate para skadimit të afatit në të cilin është zgjedhur:

- me shkarkim nga ana e Kuvendit ,shkarkim nga ana e Qeverisë, me dhënien e dorëheqjes dhe me fuqinë e ligjit .

Ndërprerja e mandatit të Kryetarit të Komunës me dorëheqje ose me fuqinë e ligjit, konstatohet me aktin e Kuvendit.

Neni 87 a

Kuvendi mund të shkarkojë Kryetarin e Komunës nëse:

- Në afatin e caktuar nuk propozon buxhetin dhe llogarinë përfundimtare;
 - Nuk siguron aplikimin e plan- programeve zhvillimore;
 - Në afatin e caktuar nuk i dorëzon Kuvendit raportin për punën e tij dhe punën e organeve të administratës lokale dhe shërbimeve;
 - Nuk zbaton vendimet gjyqësore ;
 - Nuk siguron kryerjen e punëve të tjera nga kompetenca e Komunës të vërtetuar me ligj, statut dhe dispozita të tjera .
- Propozimin për shkarkimin e Kryetarit të Komunës mund ta iniciojnë së paku 1/3 e këshilltarëve të Kuvendit
- Propozimi i arsyetuar i dorëzohet me shkrim Kryetarit të Kuvendit.
- Kryetari i Kuvendit , propozimin e inicuar ia prezanton këshilltarëve .
- Rreth propozimit për shkarkim hapet debat.

Neni 87 b

Kryetari i Komunës ka të drejtë që në mbledhjen e Kuvendit të shprehet rreth propozimit të inicuar .

Kuvendi për propozimin e shkarkimit të Kryetarit të Komunës vendos në afat prej 30 ditësh nga dita e inicimit të propozimit , me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve .

Neni 87 v

Qeveria mund të shkarkojë Kryetarin e Komunës, nëse ai në një afat prej 6 mujash nuk kryen kompetencat e tij .

Konsiderohet se Kryetari i Komunës nuk i kryen punët nga kompetencat e tij nëse nuk siguron :

Zbatimin e ligjit , dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme , aplikimin e dokumenteve strategjik me rëndësi shtetërore, por dhe nuk kryen punët nga kompetencat e veta, me çgje pengon realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut .

Nëse Kryetari I Komunës nuk kryen detyrimet nga paragrafi 2 I këtij neni, Qeveria do t'i tërheqë vërejtjen që në një afat të caktuar të marre masa për kryerjen e detyrimeve nga kompetencat e veta me çgje do të njoftojë Kuvendin.

Me propozim të Ministrive përkatëse për punët e veteadministrimit lokal , Qeveria do të shkarkojë Kryetarin e Komunës nëse Kryetari edhe pas tërheqjes së vërejtjes nga paragrafi 3 I këtij neni , nuk siguron kryerjen e punëve nga kompetencat e veta .

Me propozim nga paragrafi 4 I këtij neni, Ministria dorëzon dhe sqarimin e Kryetarit të Komunës .Kundër venimit të Qeverisë për shkarkimin e Kryetarit të Komunës, Kryetari I Komunës mund të dorëzojë ankesë në Gjykatën e Drejtësisë së Malit të Zi. Procedimi I ankesës është urgjent.

Neni 87 g

Kryetari I Komunës mund të japë dorëheqje .

Dorëheqja I jepet Kuvendit me shkrim.

Kryetari I Kuvendit dorëhqjen ia prezanton këshilltarëve

Në rast të dhënies së dorëheqjes, Kryetarit të Komunës I pushon funksioni në ditën e mbajtjes së mbledhjes në të cilën ka dhënë dorëheqje, respektivisht në mbledhjen e parë të radhës nëse dorëheqja është dhënë midis dy mbledhjeve .

Dorëheqjen nga paragrafi 1 I këtij neni dhe ndërprerjen e funksionit në këtë bazë e konstaton Kuvendi në mbledhje .Rreth dorëheqjes nuk votohet.

Kryetari I Kuvendit për shkak të zgjedhjes së Kryetarit të ri të Komunës do të thërrase Kuvendin në afat prej 15 ditësh nga dita e konstatimit të dorëheqjes, nëse dorëheqja është dhënë në mbledhjen e Kuvendit, si dhe në rast kur dorëheqja është dhënë midis dy mbledhjeve .

Neni 87 d

Kryetarit të Komunës I pushon mandati me fuqinë e ligjit:

1. Pas përfundimit të mandatit
2. Kur vërtetohet që me vendimin e plotfuqishëm është privuar nga aftësitë e punës
3. Kur ligjërisht është me burg me shume se 6 muaj I denuar
4. Me ndrimin e vendbanimit
5. Në rast të tjera të parapara me ligj .

REVOKIM

Neni 88

-fshihet-

Neni 89

-fshihet-

Neni 90

-fshihet-

Neni 91

-fshihet

ÇËSHTJA E BESUESHMËRISË

Neni 92

Kryetari i Komunës mund të shtrojë pyetjen e besueshmërisë së qytetarëve.

Çështjen e besueshmërisë ndaj Kryetarit të Komunës mund ta parashtojë edhe Kuvendi në rast se qytetarëve u shkurtohen të drejtat apo liritë, moskryerja e punëve në mënyrë kualitative, nuk realizohen programet zhvillimore dhe aktet e

tjera, i bëhen dëme të mëdha material Komunës, nuk i paraqitet Kuvendit Raporti i punës dhe kur Kuvendi nuk e vërteton aktin nga neni 86, paragrafi 1 të Statutit ose Kryetari nuk ia paraqet Kuvendit për miratim.

Iniciativën për nisjen e procesit të mosbesueshmërisë mund ta nisin së paku 1/3 e këshilltarëve ose së paku 10% e qytetarëve të Komunës dhe Qeveria.

Mbi iniciativën e nisur nga paragrafi 3 të këtij neni Kuvendi vendos me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit të iniciativës.

Neni 93

Nëse Kuvendi e pranon iniciativën nga paragrafi 3 të nenit paraprak, nis procedurën e besueshmërisë së Kryetarit të Komunës.

me vendimin për nisjen e procedurës për besueshmëri përcaktohet afati i votimeve i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë dhe as më i gjatë se 60 ditë nga dita e nisjes së procedurës dhe të çështjeve tjera me rëndësi për votim.

Neni 94

Për mosbesueshmërinë e Kryetarit të Komunës vendosin qytetarët, në pajtim me ligjin.

Nëqoftëse ndaj kryetarit të Komunës është votuar mosbesimi, Kuvendi me akt konstaton ndërprerjen e mandatit.

Çështjen e rievokimit të Kryetarit të Komunës nuk mund të iniciohet në afatin prej një viti nga dita e votimit të mosbesimit.

DORËHEQJA

Neni 95

Kryetari i Komunës mund të japi dorëheqje. Për dorëheqjen e Kryetari i Komunës lajmëron Kuvendin.

NDËRPRERJA E MANDATIT SIPAS FUQISË SË LIGJIT

Neni 96

Kryetarit të Komunës i pushon mandati me fuqinë e ligjit:

1. me kalimin e mandatit;
2. kur vërtetohet se me vendimin e plotfuqishëm i është hequr aftësia për punë;
3. kur plotfuqishëm është dënuar për vepër e cila e bën të padenjë për kryerjen e funksionit;
4. kur plotfuqishëm është dënuar me dënim burgimi më shumë se gjashtë muaj;
5. me ndërrimin e vendbanimit;
6. për raste të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 97

Kur Kryetarit të Komunës, në raste të përcaktuara me ligj, i pushon mandati, funksionin e Kryetarit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Komunës e kryen nënkryetari I Komunës, nëse Komuna ka më shumë nënkryetarë, funksionin e Kryetarit të Komunës e kryen nënkryetari I Komunës të cilin e cakton Kuvendi.

Neni 98

-fshihet-

3. NËNKRYETARI I KOMUNËS

Neni 99

Komuna ka një ose më shumë nënkryetarë.

Nënkryetarin e Komunës e emëron dhe shkarkon Kryetari i Komunës me pëlqimin e Kuvendit.

Neni 100

Për punën e vet nënkryetari i përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit.

Nënkryetari zëvendëson Kryetarin e Komunës në rast të mungesës së tij ose pengesës dhe kryen punë tjera të cilat ia beson Kryetari.

Neni 101

Mandati i nënkryetarit të Komunës nuk zgjat sa dhe mandati i kryetarit të Komunës, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Nënkryetarit të Komunës i përfundon mandate para kohës së caktuar me shkarkim, me dhënien e dorëheqjes dhe në raste tjera të parapara me ligj.

IV. QEVERISJA LOKALE

1. LLOJET E ORGANEVE DHE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Neni 102

Për kryerjen e administratës themelohen organet e qeverisjes lokale (sekretariatet, entet, drejtoritë, byrotë, zyret etj.).

Për kryerjen e punëve specifike themelohet policia komunale, shërbimet dhe qendrat e veçanta.

Për kryerjen e punëve që kërkojnë njohuri të veçanta profesionale dhe pavarësi në punë, me vendimin e Kryetarit të komunës mund të themelohen agjensitë.

Aktin për organizimin e brendshëm të organeve dhe shërbimeve nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni e bie drejtuesi I organit ndërsa për drejtoritë me pëlqimin e Kryetarit të Komunës.

Neni 103

Komuna themelon organet e administratës lokale si:

- sekretariatit për kryerjen e punëve nga lëmia e planifikimit dhe rregullimit të hapësirës, finansave, buxhetit dhe mbikëqyrjes komunale;
- entet për kryerjen e punëve nga lëmia e udhëheqjes me pasurinë e Komunës;
- drejtoritë për kryerjen e punëve nga lëmia e menaxhimit me hapësirat afariste, mirëmbajtjen investuese të objekteve banesore dhe të parkingjeve publike.
- byronë për kryerjen e punëve të organeve të Komunës dhe administratës lokale nga lëmia e servisit publik për palë dhe shërbimeve të veçanta, të punëve lekturuese dhe stenodaktilografike.

Për kryerjen e punëve për rregullimin, shfrytëzimin, avancimin dhe mbrojtjen e tokës për ndërtim mund të themelohet ndërmarrja ose organizatë tjetër.

Neni 104

Kundërthëniet në lidhje me kompetencat në mes të organeve të qeverisjes lokale I zgjidh administrator kryesor.

Kundërthëniet në lidhje me kompetencat në mes të organeve të qeverisjes lokale, shërbimeve publike dhe të personave juridik të cilave me vendimin e Kuvendit u është besuar kryerja e punëve të caktuara e zgjidh kryetari I Komunës.

2. PUNËT E ADMINISTRATËS LOKALE

Neni 105

Administrata lokale:

1. zbaton ligjet, dispozitat e tjera dhe aktet e përgjithëshme,
2. përgatit projekt vendimet dhe aktet e tjera në pajtim me rregullativën pozitive ligjore, që I bien organet e veteadministrimit lokal;
3. kryen mbikëqyrjen administrative;
4. kryen punët profesionale dhe punët e tjera të cilat ia besojnë organet e veteadministratës lokale;
5. zgjidh në procedimin administrativ të shkallës së parë mbi të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, të personave juridik dhe të tjerëve;
6. udhëheq evidencat publike dhe të tjera të caktuara me ligj dhe me akte të përgjithshme të veteadministrimit lokal;
7. zgjidh procedimet për kundërvajtje në përputhje me ligjin.
8. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Statut dhe akte të tjera.

Me paraqitjen e kërkesës së qytetarit, për zgjidhjen sipas të drejtës dhe obligimit të tij të parapare, organi kompetent i administratës të cilit i është drejtuar kërkesa në komunikimin e ndërsjellë me organet tjera drejtuese të Komunës së Ulqinit do të sigurojnë grumbullimin e njoftimeve të duhura dhe dokumentacionit në mënyrë që me dorëzimin e kërkesës të vendoset në afatin më të shkurtër.

3. ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS LOKALE

3.1. ADMINISTRATORI KRYESOR

Neni 106

Kryeadministratori koordinon punën e organeve të administrates lokale dhe shërbimeve, kujdeset për ligjshmërinë, efikasitetin dhe ekonomësinë e punës së tyre, jep udhëzime profesionale dhe udhëzime rreth mënyrës së qasjes në kryerjen e punëve, jep mendime në aktin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e punëve të organeve të administrates lokale dhe shërbimeve dhe merret me të tjera punë të cilat ia beson Kryetari I Komunës. Kryeadministratori ka kompetenca të organit të shkallës së dytë në çështje administrative nga kompetenca e Komunës . Për kryerjen e punëve të Kryeadministratorit, mund të formohet shërbimi .

Neni 107

Administratorin kryesor e emëron dhe shkarkon Kryetari i Komunës, me pëlqimin e Kuvendit.

Administratori kryesor emërohet në bazë të konkursit publik, për një afat 4 vjeçarë.

Për administrator kryesor mund të jetë i emëruar personi i cili ka të kryer fakultetin juridik, provimin profesional për punë në administratën shtetërore dhe së paku 5 vjet përvojë pune.

Administratori kryesor për punën e vet dhe punën e shërbimeve të veta i përgjigjet Kryetarit të Kuvendit dhe Kuvendit.

Neni 108

Kryeadministratori mund të shkarkohet nga detyra nëqoftëse nuk i kryen ose pa ndërgjegje I kryen punët e caktuara me ligj dhe statut.

Kryetari I Komunës nis procedure për dhënien e pëlqimit për shkarkimin e Kryeadministratorit në formë të shkruar me arsyesim të cilin ia dërgon Kuvendit . Rreth propozimit për dhënien e pëlqimit për shkarkimin e Kryeadministratorit debatohet dhe votohet në Kuvend.

Në procesin e shkarkimit të Kryeadministratës ka të drejtë që në mledhjen e Kuvendit të shprehet për arsyesim që e ka kërkuar shkarkimin e tij , për dhënien e pëlqimit në emërimin respektivisht shkarkimin e Kryeadministratorit , Kuvendi vendos me shumicë votash nga numri I përgjithshëm I këshillatrëve.

3.2. KRYESHEFI I ORGANIT TË ADMINISTRATËS LOKALE

Neni 109

Me punën e organit administrativ udhëheq shefi i organit.

Shefi I organit vendoset në bazë të konkursit publik , në një periudhë prej 4 vjetësh.

Kryeshefi i organit për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Komunës. Kryeshefi i organit vendos për zgjedhjen dhe shpërndarjen e zyrtarëve dhe zëvendësve dhe kryen punë të tjera, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

Neni 110

Kryeshefi i organit të administratës lokale është përgjegjës për ligjshmërinë, efikasitetin dhe ekonomësinë e punës së organit të cilin e udhëheq.

Mbi gjendjen në lëmin e administrimit me të cilin udhëheq, shefi i organit I jep raport Kryetarit të Komunës sipas kërkesës së tij , së paku një herë në vit.

Nëse kryeshefi i organit gjegjësisht organi me punën e të cilit udhëheq nuk i kryen në afat dhe ligjërisht punët nga kompetencat e veta, Kryetari I Komunës do të shkarkojë Kryeshefin e organit.

3.3. MENAXHERI

Neni 111

Komuna ka një menaxher.

Menaxheri koordinon punën në përgatitjet për realizimin të projekteve dhe programeve zhvillimore me të cilët:

nxitet zhvillimi ekonomik, sigurohet mbrojtja e mjedisit jetësorë, zhvillimi I qënueshëm, nxiten inicjativet sipërmarrëse, partneriteti privat dhe publik dhe inicohet ndryshimi I dispozitave me qëllim të krijimit të ambijentit inkurajues për zhvillimin e vetëadministrimit lokal.

Menaxherin e emëron dhe e shkarkon Kryetari i Komunës.

Menaxheri caktohet në bazë të shpalljes publike me kohë të pacaktuar.

Menaxheri së paku një herë në vit paraqet raportin mbi punën e vet Kryetarit të Komunës.
Për punën e vet menaxheri i përgjigjet Kryetarit të Komunës.

3.4. POLICIA KOMUNALE

Neni 112

Komuna ka shërbimin për kryerjen e mbikqyrjes komunale (në tekstin që vijon: policia komunale).

Mbikqyrjen mbi ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e punës së policisë komunale e kryen Kryetari I Komunës.

Policia komunale siguron rendin komunal në lëmën e parkimit, deponimit të mbeturinave, furnizimit me ujë, shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike, pastërtisë publike, ndriçimit publik, mirëmbajtjes së tregut, parqeve, sipërfaqeve të gjelbërta, shenjave dhe sinjalizimit të komunikacionit, varrimeve, të rrugëve lokale, zhurmës, orarit të punës, transportit të udhëtarëve në komunikacionin urban dh endërrurban, transportit autor-taxi, realizon vendimin mbi ndlimin e ndërtimeve gjate sezonit, u ofron qytetarëve shërbime informacioni dhe kryen punë të tjera nga kompetencat e Komunës të cilat janë të parapara me ligj dhe me vendimin e Kuvendit.

Në pikëpamjen e të drejtave dhe detyrave dhe veprimit të kryerjes së punës së policisë komunale përshtatshëmrisht aplikohen dispozitat ligjore me të cilat rregullohet kontrolli inspektues, gjegjësisht mbikëqyrja dhe dispozita tjera.

Neni 112 a

Policia Komunale ka kartën identifikuese,uniformën zyrtare dhe shenjat .

Formën dhe përmbajtjen e kartave identifikuese, shenjave , pamjen , përmbajtjen dhe shfytëzimin e uniformës dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e policisë komunale I përcakton Kuvendi I Komunës.

3.5. SHËRBIMI I MBROJTJES

Neni 113

Komuna ka shërbimin e mbrojtjes.

Shërbimi i mbrojtjes siguron shpëtimin dhe mbrojtjen e pasurisë dhe personave nga zjarri, eksplozimet, përmbytjet dhe situatave aksidentale dhe të jashtëzakonshme .

Kontrollin mbi ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e punës së Shërbimit të mbrojtjes e bën Kryetari i Komunës.

3.6. QENDRA INFORMATIVE

Neni 114

Organet e komunës, shërbimet publike dhe subjektet juridike që kryejnë obligime publike dhe ofrojnë shërbime publike qytetarëve, në kryerjen e punëve dhe detyrave të veta, shfrytëzojnë mjetet e teknologjisë bashkëkohore të informimit dhe komunikimit.

Komuna themelon Qendrën informative për kryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni.

3.7. SHËRBIMET PUBLIKE

Neni 115

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike Komuna themelon shërbimet publike si shoqëri ekonomike, institucione dhe në forma tjera të organizimit në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.

Shërbimet publike në lëmën e veprimtarive komunale dhe veprimtarive të ujësjellësit dhe kanalizimit, themelohen si dërmarrje publike.

Shërbimet publike në lëmën e rregullimit hapësinor, turizmit, arsimit, kulturës, kulturës fizike dhe sportit, kulturës teknike, të mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijës, punësimit, mbrojtjes primare shëndetsore dhe në lëmi të tjera themelohen si institucione publike.

4. KLAUZOLA E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Neni 116

Punët e Kryetarit , Nënkyetarit dhe Kryeadministratorit nuk përputhen me funksionin e Këshilltarëve dhe të anetarëve në organet drejtuese të shërbimeve publike themelues I të cilëve është njësia e vetëadministrates lokal. Punët e kryeshefit të organit të administrates lokale dhe drejtuesve të shërbimeve publike themelues I të cilëve është njësia e vetëadministratës lokale nuk përputhet me funksionin e këshilltarit dhe antarësi ne organet drejtuese në shërbimet publike. Personat nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni nuk mund të jenë të angazhuar nga shërbimet publike, personat juridik dhe fizik për kryerjen e çfarëdo pune qoftë që janë të lidhura me punët e organeve të vetëadministrimit lokal dhe në funksion ku janë realizimet e të drejtave dhe intereseve të tyre kundrejtë organeve lokale.

5. STATUSI JURIDIK I TË PUNËSUARËVE

Neni 117

Kryetari dhe Nënkyetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit dhe Administratori kryesor janë funksionerë lokal.

Neni 118

Të punësuarit në organet e administratës lokale janë zyrtarë dhe nëpunës të cilët në mënyrë profesionale kryejnë punët nga kompetencat e vetëadministrimit lokal.

Titullin zyrtar dhe kushtet për kryerjen e tyre i përcakton Qeveria.

Personat nga paragrafi 1 të këtij neni punësohen në bazë të shpalljes publike (konkursit).

Neni 119

Në pikepamjen e statusit juridik të funksionerëve lokal, të zyrtarëve dhe nëpunësve aplikohen dispozitat me të cilat rregullohet statusi i funksionerëve republikan, të zyrtarëve dhe nëpunësve shtetëror.

Fitimin dhe të drejtat tjera në bazë të punës së funksionerëve lokal, zyrtarët dhe nëpunësit e realizojnë në përputhje me ligjin dhe dispozitat e Kuvendit të komunës.

Kryetari i Kuvendit të komunës i cili funksionin e kryen si volunteer ka të drejtë në kompenzim për kohën gjatë së cilës kryen funksionin në pajtim me vendimin e Kuvendit të komunës.

Neni 120

Mbi shkarkimin e zyrtarëve në organet e administratës lokale vendos kryeshefi i organit të administratës lokale.

Rreth shkarkimit të kryeshefave të organeve të administrates lokale dhe kryeadministratorit vendos Kryetari i Komunës.

Neni 121

Është i ndaluar organizimi politik në organet e administratës lokale.

Të punësuarve në organet e administratës lokale u është e ndaluar që në kryerjen e punëve të veta të shprehin dhe përfaqësojnë bindjet e tyre politike.

Personat e punësuar në administratën lokale dhe në shërbimet publike nuk mund të pushohen nga detyra dhe as tu acarohet pozita për shkak të anëtarësisë në organizatë politike apo sindikale.

V. MËNYRA E MBIKËQYRJES MBI PUNËN E ORGANEVE TË KOMUNËS DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

1. MBIKËQYRJA MBI PUNËN E KRYETARIT TË KOMUNËS DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

Neni 122

Kuvendi mbikëqyrë punën e Kryetarit të Komunës dhe shërbimeve publike.

Kryetari i Komunës deri në fund të dhjetorit të vitit vijues dorëzon planin vjetor për vitin që vjen.

Mbikëqyrja nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohet me shqyrtimin dhe miratimin e raportit vjetor mbi punën e Kryetarit të Komunës, gjegjësisht të shërbimeve publike.

Kryetari i Komunës i paraqet Kuvendit raportin vjetor mbi punën e administratës lokale dhe të agjensioneve që i themelon.

Neni 123

Kryetari i Komunës mbikëqyr punën e administratës lokale.

Mbikëqyrja nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohet me meritatimin e planit vjetor të punës dhe raportit mbi punën e organeve të qeverisjes lokale.

2. MBIKËQYERJA ADMINISTRATIVE

Neni 124

Organet e administratës lokale bëjnë mbikëqyrje administrative dhe këto:

- 1) Me mbikëqyrje të ligjshmërisë së akteve të shërbimeve publike me të cilat rregullohen të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të qytetarëve dhe personave juridik;
- 2) Me mbikëqyrje të ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë të punës së shërbimeve publike;
- 3) Mbikëqyrjen inspektuese.

Neni 125

Në kryerjen e mbikëqyrjes administrative organet e administratës lokale:

1. I propozojnë Kryetarit të komunës ndërprerjen nga realizimi i akteve të përgjithshme apo të dispozitave të veçanta të tyre që nuk janë në pajtim me Statutin dhe aktet e tjera të organeve të veteadministrimit lokal, deri në përfundimin e procesit për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të akteve të përgjithshme;
2. merr iniciativën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të shërbimeve publike;
3. urdhërojnë masa për kryerjen e detyrave të caktuara;
4. Propozojnë masa për tejkalimin e problemeve, gjegjësisht mënjanimin e lëshimeve në punë;
5. merr iniciativën për ndërrimin e dispozitave;
6. paraqesin kërkesën për nxitjen e procesit për kundërvajtje, aktpadisë ose padinë për shkelje ligjore;
7. lajmërojnë organet tjera, nëse egzistojnë shkaqe për marrjen e masave nga kompetencat e tyre;
8. ndërmarrin dhe masa të tjera të parapara me dispozita të veçanta.

VI. MËNYRA E SIGURISË PUBLIKE TË PUNËS SË ORGANEVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

Neni 126

Puna e organeve të veteadministrimit lokal është publike.

Neni 127

Me qëllim të sigurisë publike dhe transparencës së punës së organeve të komunës dhe të shërbimeve publike, Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit dhe administratori kryesor janë të detyruar që së paku njëherë në tre muaj përmes mjeteve të informimit publik apo në mënyrë tjetër të përshtatshme të informojnë qytetarët mbi aktivitetet e realizuara dhe të planifikuara.

Neni 128

Organet e qeverisjes lokale dhe shërbimeve publike janë të detyruara që të njoftojnë opinionin mbi kryerjen e punëve nga kompetencat e veta dhe ta informojnë atë për punën e vet përmes mjeteve të informimit publik apo në mënyrë tjetër të përshtatshme.

Neni 129

Publiciteti dhe transparenca e organeve të qeverisjes lokale dhe të shërbimeve publike sigurohet:

1. Me shikimin e drejtpërdrejtë të akteve dhe dokumentave të tjera zyrtare që kanë të bëjnë me realizimin e funksionimit të veteadministrimit lokal dhe me realizimin e të drejtave të qytetarëve;
2. me pjesëmarrjen e qytetarëve në diskutimin publik gjatë procesit të miratimit të vendimeve me të cilat rregullohen çështjet me interes të drejtpërdrejtë për popullatën lokale;
3. me publikimin e akteve të përgjithëshme dhe akteve të tjera në “Fletën zyrtare të MZ” – dispozitat komunale, në fletën zyrtare të komunës së Ulqinit dhe në mjetet e tjera të informimit;
4. me organizimin e formave të ndryshme të edukimit të qytetarëve;
5. me publikimin e informative mbi punën e organeve të Komunës, të qeverisjes lokale dhe të shërbimeve publike;
6. duke iu mundësuar qytetarëve dhe personave juridik dhënien e vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve mbi punën e organeve dhe shërbimeve të Komunës;

Mënyra dhe veprimi për publikimin dhe transparencës nga paragrafi 1 i këtij neni, më saktësisht përcaktohen me Rregulloren e punës së Kuvendit, Vendimin për organizimin e qeverisjes lokale, gjegjësisht Statutin e shërbimit publik.

Neni 130

Organet e administratës lokale janë të detyruara që publikisht të shpallin mbajtjen e këshillimeve ose të formave tjera të përpunimit profesional dhe të debatojnë për çështjet nga veprimtaria e tyre, të mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe përcjelljen e punës nga ana e mjeteve të informimit.

VII VETËADMINISTRIMI I BASHKËSISË LOKALE

Bashkësia lokale

Neni 131

Në bashkësinë lokale qytetarët vendosin dhe marrin pjesë në vendimmarrje për realizimin e nevojave lokale dhe dhe interesave nga fushat e: rregullimit të vendbanimeve, strehimit, mbrojtjen e konsumatorëve, kultures, kulturës fizike, mbrojtjen dhe zhvillimin e ambientit jetësor, si dhe nga fushat e tjera të jetës dhe punës në pajtim me këtë Statut.

Neni 132

Qytetarët themelojnë bashkësinë lokale në pajtim me ligjin.

Me vendimin e Kuvendit rregullohen kushtet e themelimit, punët, organet dhe procedimi zgjedhor, organizimi dhe puna e organeve, mënyra e vendimmarrjes, finansimit dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e bashkësisë lokale.

Duke përjashtuar paragrafin 1 të këtij neni Kuvendi mundet, kur kjo është e domosdoshme për të realizuar të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, përkohësisht, deri në vetorganizim, të themelojë bashkësitë locale.

Kryetari i Komunës bën kontrollin mbi punën e bashkësive lokale dhe të qendrave lokale në aspektin e ligjshmërisë së akteve të tyre.

Neni 133

Iniciativën për organizimin e bashkësisë lokale, bashkimin e atyre ekzistuese, ndarjen e vendbanimeve të veçanta apo pjesëve të vendbanimeve dhe bashkangjitja e tyre me bashkësinë tjetër lokale apo organizimin e bashkësisë lokale të re e inicojnë qytetarët nga territori gjegjësisht në tubimet e qytetarëve, të cilën ia përcjellin Kuvendit të komunës për shqyrtim.

Neni 134

Kuvendi i komunës është e detyruar që të shqyrtojë çdo iniciativë të tubimit të qytetarëve. Me rastin e shqyrtimit të iniciativës Kuvendi është i obliguar që posaçërisht të ketë parasysh:

- madhësinë e territorit dhe numrin e banorëve,
- shkallën e zhvillimit të territorit, nevojat e banorëve të atij territorit,
- ekzistimin e kushteve që në atë territor të themelohet bashkësia lokale, gjegjësisht se a mundën qytetarët në atë territor në mënyrë të pavarur të shprehin, të pajtohen dhe të plotësojnë interesat dhe nevojat e përbashkëta,
- sigurimin e bazës material për plotësimin e interesave dhe nevojave të përbashkëta dhe
- zhvillimin e bashkëpunimit për zgjidhjen e çështjeve me interes të përbashkët me bashkësitë fqinje dhe bashkësitë e tjera lokale.

Neni 135

Vendimi për themelimin e Bashkësisë lokale konsiderohet i miratuar nëse për atë deklarohen shumica e qytetarëve të regjistruar në listat zgjedhore nga territori për të cilin organizohet bashkësia lokale.

Neni 136

Mjetet për plotësimin e nevojave të popullatës lokale në bashkësi lokale sigurohen nga:

1. të ardhurat e Komunës të cilat i jepen bashkësisë lokale;
2. mjetet vetanake të popullatës lokale të cilat i bashkon drejtpërdrejtë me vetkontribut ose në ndonjë mënyrë tjetër;
3. mjetet të cilat për aktivitete të formave të caktuara të bashkësisë lokale mund t'i japin personat juridik dhe fizik të interesuar;
4. kompenzimet për shërbime që me aktivitetet e veta i realizon bashkësia lokale;
5. dhuratat, donacionet dhe mjetet e tjera.

Neni 137

Funkcionin e ekzekutivit në bashkësinë lokale e kryen Këshilli i bashkësisë lokale. Për kryerjen e funksionit të ekzekutivit këshilli i bashkësisë lokale:

- bie vendimin për thirrjen e tubimit të qytetarëve;
- kujdeset për realizimin e përfundimeve të miratuara në tubimin e qytetarëve;
- koordinon aktivitetet e përgjithshme për realizimin e punëve nga fushëveprimi i punës së bashkësisë lokale dhe në lidhje me këtë merr masat gjegjëse;
- kujdeset për pasurinë e bashkësisë lokale, si dhe pasurinë e cila i është dhënë për përdorim dhe menaxhim nga ana e Kuvendit të komunës;

- përfundon punët juridike – bashkëpunon me organet e Komunës, shërbimet publike, institucionet dhe subjektet ekonomike dhe
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me aktet të përgjithshme dhe të veçanta të Kuvendit të komunës.

Neni 138

Këshilli i bashkësisë lokale mund të ketë nga pesë deri në pesëmbëdhjetë anëtarë, varësisht nga numri i qytetarëve të regjistruar në listat zgjedhore të asaj bashkësi lokale.

Këshillin e zgjedhin qytetarët në tubimet e qytetarëve në afat prej katër vjetësh.

Me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit qytetarët janë të detyruar të sigurojnë përfaqësimin e të gjitha pjesëve të bashkësisë lokale në këshill.

Këshilli zgjedh nga radhët e veta kryetarin dhe nënkryetarin e këshillit në mbledhjen e parë konstitutive.

Neni 139

Kryetari i Këshillit përfaqëson bashkësinë lokale dhe Këshillin, kujdeset për organizimin e punës së Këshillit, thërret mbledhjet e Këshillit, propozon rendin e ditës dhe udhëheq me mbledhjet, kujdeset për transparencën e punës, nënshkruan aktet që i bie Këshilli, kryen punë të tjera që ia beson Këshilli.

Nënkryetari i Këshillit zëvendëson kryetarin në rastet e mungesës së tij ose pengimit të tij dhe kryen punë të tjera që ia beson kryetari.

Me rregulloren e Këshillit më saktësisht rregullohen çështjet e konstituimit, të organizimit të punës, realizimit të drejtave dhe detyrave të Këshillit, procedimit të zgjedhjes dhe shkarkimit të kryetarit dhe nënkryetarit të Këshillit dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Këshillit.

Neni 140

Mënyra e pjesëmarrjes së popullatës lokale për vendimmarrjen mbi punët me interes të veçnatë dhe çështje të tjera në lidhje me organizimin dhe punën e bashkësisë lokale, do të rregullohen me aktin mbi themelimin dhe Statutin e bashkësisë lokale në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.

Qendra e Lokale

Neni 141

-fshihet-

Neni 141 a

Nismën për formimin e Qendrës së bashkësive mund ta marrë Këshilli teritorijal I njerës ose me shumë bashkësive lokale që kanë lidhje të perbashkëta zhvillimore dhe ekonomike. Iniciativa për themelimin e Qendrës lokale përmban: emrin dhe selinë, arsytet për themelimin, mënyrën e finansimit si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Qendrës lokale.

Neni 141 b

Qendra lokale themelohet me vendimin e Kuvendit të Komunës. Vendimi për themelimin e Qendrës lokale përmban: Emrin dhe selinë, organet e qendrës lokale, llojin, volumin dhe mënyrën e kryerjes së punëve, mënyrën e finansimit, përgjegjësinë për kryerjen e punëve, transparencën e punës, mënyrën e paraqitjes dhe prezantimin e qendrës lokale deri në zgjedhjen e organeve të qendrës lokale dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e qendrës lokale.

Neni 141 c

Organet e qendrës lokale janë: këshilli I qendrës lokale dhe kryetari I këshillit të qendrës lokale.

Këshilli I qendrës lokale numron më së paku 7 e më së shumti 11 anëtarë që vërtetohen me vendim të kuvendit për themelimin e qendrës lokale. Në këshillin e qendrës lokale çdo bashkësi lokale e cila ka hyrë në përbërje të qendrës lokale ka me së paku nga një përfaqësues. Anëtarët e këshillit të qendrës lokale I zgjedh dhe shkarkon këshilli I bashklësive lokale nga territori për të cilat themelohet qendra lokale.

Neni 141 d

Këshilli qendres lokale ka Kryetarin I cili përfaqëson qendrën lokale, kryeson mbledhjet e këshillit dhe koordinon realizimin e plan programeve të vërtetuara .Kryetarin e këshillit të qendrës lokale e zgjedh këshilli nga rradhët e anëtarëve të vet . Në pyetjet të cilat kanë të bëjnë me e proceduren e mënyrës së zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të këshillit të qendrës lokale dhe kryetarit të këshillit, aplikohen rregulloret e dispozitave të bashkësive lokale.

Neni 141e

Keshilli I Qendres lokale ka sekretarin ,Sekretarin e Qendres e emeron Keshilli . Keshilli I Qendres lokale mund te aftesoje sherbimin profesional per kryerjen e puneve profesionale, administrative , teknike dhe pune te tjera per nevojat e qendres me te cilat udheheq Sekretari I qendres.

Neni141f

Per kryerjen e puneve te caktuara nga kompetencat shtetore dhe administrata lokale , e vecmas kur I perkasin realizimit te te drejtave dhe nevojave te qytetareve organeve lokale dhe administrates shtetore mund te organizojne punen ne qendren lokale ne pajtushmeri me ligjin, statutin dhe vendimet

Neni 142.

Rregjistrin e bashkesive lokale dhe qendrave lokale e udheheq organi kompetent komunal .Me futjen ne rregjister bashkesia lokale , respektivisht qendra lokale , fiton cilesine e personit juridik

VIII. PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË REALIZIMIN E VETEADMINISTRIMIT LOKAL

Neni 143

Format e pjesëmarrjes së drejtepërdrejte të qytetarëve në deklarimin dhe vendimmarrjet e tyre janë: iniciativa, iniciativa qytetare, tubimi i qytetarëve, referendumi komunal dhe lokal dhe format e tjera të deklarimit dhe vendimmarrjes (peticioni, propozimi dhe ankesa qytetare).

Për deklarimin e qytetarëve mbi çështjet e caktuara nga kompetencat e Komunës, mund të shpallet referendumi për territorin e komunës (referendumi komunal) ose për një pjesë të territorit të Komunës (referendumi lokal).

1. FORMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE

1.1. INICIATIVA

Neni 144

Qytetarët kanë të drejtë të marrin iniciativën para organeve kompetente për të shqyrtuar vendimmarrjen mbi çështjet e caktuara me interes për popullatën lokale, e sidomos për:

- ndërtimin e objekteve komunale dhe të infrastrukturës;
- ndërtimin, rekonstruktimin dhe riparimin e rrugëve lokale;
- ofrimin dhe kualitetin e shërbimeve komunale;
- përcaktimin e linjave në komunikacionin urban dhe periferik
- zhvillimin e sportit, kulturës dhe artit;
- ndërtimin, zgjerimin dhe rregullimin e varrezave;
- përcaktimin e kohëzgjatjes së orarit të punës në objektet hoteliere;
- mbrojtja e përmendoreve dhe monumenteve;
- mbrojtjes nga zhurma.

Neni 145

Mbi iniciativën e marrë organi kompetent është i obliguar të marrë qëndrim dhe në afatin prej 30 ditësh të lajmërojë parashtruesin e iniciativës.

Nëse organi nuk vepron sipas iniciativës, parashtruesi i iniciativës mund t'i drejtohet Kryetarit të Komunës ose Kuvendit të komunës.

1.2. INICIATIVA QYTETARE

Neni 146

Qytetarët kanë të drejtë për iniciativën qytetare.

Me iniciativën qytetare propozohet prurja ose ndryshimi i akteve me të cilat rregullohen çështjet e rëndësishme nga kompetencat e veteadministrimit lokal.

Nëse organi kompetent nuk e pranon iniciativën qytetare, mbi çështjen për të cilën është parashtruar iniciativa qytetare mund të shpallet referendum i cili do të mbahej në afatin prej 90 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Neni 147

Iniciativa qytetare mund të shtrohet për problemet si:

- planifikimi dhe rregullimi hapësinor;
- mbrojtja e ambientit jetësor;
- rregullimit të qytetit;
- vënien e vetekontributit;
- përcaktimin e tatimeve, kompenzimeve dhe taksave;
- mbrojtjen sociale të fëmijëve, invalidëve dhe personave të hendikepuar në gjendje të nevojave sociale;
- rregullimin dhe shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe
- çështjeve të tjera të rëndësishme nga kompetencat e Komunës.

Neni 148

Iniciativën qytetare mund ta parashtrorë së paku 3% e qytetarëve.

Iniciativa qytetare përmban propozimin nga kompetencat e komunës dhe numrin e nevojshëm të nënshkrimeve të qytetarëve me emër dhe mbiemër dhe të dhëna të tjera në bazë të të cilave vërtetohet autenticiteti i nënshkruesëve (adresa e banimit, numri i amzës ose numri i letërnjoftimit).

Neni 149

Propozimi i iniciativës qytetare është i ligjshëm nëqoftëse me këtë propozohet ose kërkohet prurja gjegjësisht ndryshimi i vendimit të caktuar në pajtim me ligjin, dhe e cila është në kompetencat e Komunës.

Propozimi është statutar nëse ka të bëjë me çështjet nga neni 152 të Statutit.

Iniciativa është e plotë nëse nënshkrimet e qytetarëve plotësojnë të gjitha kushtet të parapara në nenin 148 paragrafi 2 të Statutit.

Neni 150

Organi i Komunës të cilit i është drejtuar iniciativa qytetare do t'ia dorëzojë iniciativën organit kompetent të qeverisjes lokale dhe trupit punues të Kuvendit kompetent për dispozita për të dhënë mendimin.

Komisioni për statut dhe dispozita të Kuvendit të komunës, në procedimin paraprak, vlerëson tërësinë e iniciativës, ligjshmërinë dhe statutshmërinë e propozimit.

Organet dhe trupi punues nga paragrafi 1 të këtij neni janë të obliguar që mendimin e vet ta japin në afatin prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të iniciativës.

Neni 151

Nëse iniciativa nuk është e plotë Komisioni do t'ia kthejë dorëzuesit që në afatin prej tetë ditësh ta plotësojë. Nëse propozimi nuk është i ligjshëm ose statutar Komisioni do ta hedhë poshtë. Me përjashtim, nëse propozohet vendimi tek i cili vetëm urdhëresat e veçanta nuk janë në përputhje me dispozitat pozitive ligjore Komisioni do t'ia kthejë dorëzuesit që në afatin prej tetë ditëve ta përmirësojë.

Nëse dorëzuesi i iniciativës nuk plotëson gjegjësisht propozimin nuk e përmirëson në afatin e caktuar, Komisioni iniciativën, gjegjësisht propozimin do ta hedhë poshtë si jo i rregullt.

Neni 152

Kuvendi është i obliguar që për iniciativën qytetare të deklarohet në mbledhjen vijuese pas marrjes së mendimit.

Në rast të miratimit të iniciativës qytetare, Kuvendi do të ngarkojë organin kompetent të administratës lokale që në afatin prej 60 ditësh të përgatisë propozimin e aktit për rregullimin e çështjes e cila është lëndë e iniciativës qytetare.

Në punimin e aktit organi nga paragrafi paraparak është i detyruar që të mundësojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të dorëzuesit të iniciativës qytetare.

Mbi propozimin e aktit nga paragrafi 2 të këtij neni, Kuvendi vendos me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve në Kuvend.

Neni 153

Vendimin për miratimin apo mosmiratimin e propozimit e bie Kuvendi i komunës.

Nëse Kuvendi nuk miraton propozimin, mundet që për atë propozim të shpalle referendumin në afatin prej 90 ditësh nga dita e prurjes së vendimit për mosmiratimin e propozimit.

Referendumi nuk mund të shpallet nëse vendimi për mosmiratimin e vendimit është prurë me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve në Kuvend.

1.3. TUBIMI I QYTETARËVE

Neni 154

Tubimi i qytetarëve organizohet në bashkësitë lokale si formë e drejtpërdrejtë e realizimit të qeverisjes lokale.

Qytetarët për realizimin e nevojave dhe interesave të tyre të drejtpërdrejta në tubime shqyrtojnë:

- çështjet që janë me interes të përbashkët për jetën dhe punën në një territor të caktuar;
- çështjet për të cilat vendos Kuvendi i komunës;
- nisin iniciativën dhe japin propozime, sugjestionë dhe mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara;
- nisin iniciativën për prurjen e dispozitave dhe akteve të tjera të Kuvendit të komunës.

Neni 155

Tubimin e qytetarëve e thërret këshilli i bashkësisë lokale me iniciativën e vet ose me propozimin e më së paku 1% të qytetarëve nga numri i regjistruar në listat zgjedhore të Komunës nga territori për të cilin organizohet referendumi.

Tubimin e punëtorëve mund ta thërrasi Kryetari i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës për të marrë mendimin e qytetarëve mbi çështjet e veçanta me interes lokal dhe këshilltari në Kuvendin e komunës i cili është i regjistruar në listën zgjedhore të territorit për të cilin organizohet tubimi, për të marrë mendimin për çështjen e caktuar nga ana e qytetarëve.

Tubimi i qytetarëve thirret me dërgimin e ftesës publike së paku tetë ditë para ditës së mbajtjes së tubimit.

Ftesa publikohet në mjetet e informimit, vihet në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të komunës dhe bashkësisë lokale, në objektet publike, në vëndet e tjera për shpallje, në hyrjet e ndërtesave të banimit dhe në mënyrë tjetër të përshtatshme.

Neni 156

Propozimi për thirrjen e tubimit të qytetarëve përmban në formë të shkruar në formë aresyetimi të çështjes të cilën tubimi duhet ta shqyrtojë.

Nëqoftëse propozimin për thirrjen e tubimit e paraqesin qytetarët, atëherë përmban edhe emrin dhe mbiemrin e qytetarëve, numrin e amzës, gjegjësisht numrin e letërnjoftimit, adresën dhe nënshkrimin personal.

Neni 157

Të drejtë pjesëmarrjeje dhe vendimmarrjeje në tubim kanë të gjithë qytetarët të cilët janë të shënuar në listën zgjedhore të territorit për të cilin organizohet tubimi.

Për vendosje të plotëfuqishme në tubim është e nevojshme prezenca e më së paku 5% e qytetarëve nga numri i të regjistruarve në listën zgjedhore të Komunës nga zgjedhjet e fundit për territorin në të cilin organizohet tubimi.

Tubimi i qytetarëve vendos me shumicën e votave të pjesëmarrësve prezent.

Neni 158

Organet e veteadministrimit lokal janë të detyruara që në afatin prej 60 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit të qytetarëve të shqyrtojnë kërkesat dhe propozimet dhe për këto të lajmërojnë qytetarët.

1.4. REFERENDUMI LOKAL

Neni 159

Referendumi lokal mund të shpallet për deklarimin paraprak të qytetarëve mbi çështjet me interes të drejtepërdrejtë për qytetarët nga territori për të cilin organizohet referendumi, e sidomos:

- për organizimin e vetekontributit lokal
- për ndërtimin e objekteve komunale dhe të infrastrukturës për atë territor, dhe
- për çështje të tjera me interes të qytetarëve nga ai territor.

Neni 160

Vendimin për shpalljen e referendunit lokal e bie Kuvendi i komunës me propozimin e më së paku 5% të qytetarëve nga numri i të regjistruarve në listën zgjedhore nga zgjedhjet e fundit të territorit të Komunës për të cilin kërkohet shpallja e referendunit lokal.

Veprimi i shpalljes dhe realizimit të referendunit bëhet në pajtim me ligjin, këtë Statut dhe me vendimin për shpalljen e tij.

1.5. REFERENDUMI KOMUNAL

Neni 161

Referendumi lokal mund të shpallet për deklarimin paraprak të qytetarëve në territorin e Komunës mbi çështjet e veçanta nga kompetencat e administratës lokale të parapara me ligj:

- për investime kapitale;
- për organizimin e huasë së detyrueshme;
- për organizimin e vetekontributit për territorin e Komunës ose për pjesët e veçanta të saj;
- për ndërrimin e emrit të qytetit;
- për çështjet e simboleve të qytetit (flamuri, stema, festa);
- për çështje të tjera me interes të qytetarëve nga territori i Komunës.

Neni 162

Propozimin për shpalljen e referendunit komunal mund ta bëjnë Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Komunës, më së paku 1/3 e këshilltarëve ose 5% e qytetarëve nga numri i të regjistruarve në listën zgjedhore të Komunës nga zgjedhjet e fundit.

Vendimin për shpalljen e referendunit e bie Kuvendi i komunës, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

1.6. VETEKONTRIBUTI

Neni 163

Iniciativën për marrjen e prurjen e Vendimit për vetekontribut mund ta paraqesin së paku 1/3 e këshilltarëve, Kryetari i Komunës ose së paku 5% e qytetarëve të regjistruar në listën zgjedhore nga territori i Komunës për të cilin organizohet referendumi.

Së bashku me iniciativën për shpalljen e vetekontributit, paraqitet edhe programi me të cilin përcaktohen burimet, dedikimi dhe mënyra e sigurimit të mjeteve të përgjithshme financiare për realizimin e vetekontributit.

Propozimin e vendimit për vetekontribut e verifikon Kuvendi me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Neni 164

Me vendimin për shpalljen e vetekontributit përcaktohet:

- destinimi, fusha e veprimit, koha për të cilën shpallet vetkontributi,
- shuma e përgjithëshme e mjeteve që grumbullohen,
- detyruesit e vetekontributit dhe personat që lirohen nga detyrimi,
- lartësia e vetekontributit (baza, përqindja proporcionale etj.) dhe mënyra e llogaritjes,
- mënyra e realizimit të mbikqyrjes së qytetarëve mbi shfrytëzimin e mjeteve me destinim dhe
- çështje të tjera të rëndësishme për shpalljen e vetekontributit.

Neni 165

Vendimin për shpalljen e vetekontributit e bien qytetarët drejtepërdrejt, me votim të fshehtë, më pajtim me ligjin.

Vendimi konsiderohet i miratuar kur për të votojnë shumica nga numri i përgjithshëm i qytetarëve që kanë të drejtë vote dhe janë me vendbanim në territorin në të cilin tubohen mjetet, si dhe qytetarët të cilët nuk kanë të drejtë vote dhe nuk

janë me vendbanim në territorin në të cilin tubohen mjetet nëse në atë territor kanë pasuri të patundshme (popullata lokale), ndërsa me mjete përmirësohen kushtet për shfrytëzimin e asaj pasurie.

2. FORMAT E TJERA TË DEKLARIMIT TË QYTETARËVE

Neni 166

Çdokush ka të drejtë që të paraqese ankesë civile ose t'u bëjë peticion organeve të veteadministrimit lokal, si dhe nga organet të kërkojë sqarime nga fushëveprimi i punës së tyre

Organet të cilave iu janë bërë kërkesat nga paragrafi 1 të këtij neni janë të obliguar të marrin vendimin, gjegjësisht të japin sqarimet e kërkuara në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

2.1. ANKESA QYTETARE DHE PETICIONI

Neni 167

Çdokush ka të drejtë të paraqese ankesën e qytetarit ose ti dërgojë peticion organeve të administratës lokale, si dhe nga këto organe të kërkojë sqarime nga kompetencat e tyre.

Organet të cilëve iu janë drejtuar kërkesat nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar të bien vendimin, gjegjësisht të japin sqarimet e kërkuara në afat prej 30 ditësh nga data e marrjes së kërkesës

Neni 168

Ankesa civile ose peticioni i dorëzohet në formë të shkruar Kuvendit ose kryetarit të Komunës dhe përmban lëndën e ankesës, nënshkrimin dhe të dhënat personale të paraqitësit të ankesës.

3. PLANI DHE PROGRAMI I PJESËMARRJES SË POPULLATËS LOKALE NË KRYERJEN E PUNËVE PUBLIKE

Neni 169

Me qëllim të pjesëmarrjes së popullatës lokale në prurjen e vendimeve me interes të drejtepërdrejt dhe reciprok, Kuvendi me vendim të veçantë rregullon mënyrën dhe procedurën e pjesëmarrjes së popullatës në kryerjen e punëve publike.

Neni 170

Para miratimit të programit zhvillimor të komunës, të planeve hapsinore dhe urbanistike, buxhetit dhe akteve të përgjithëshme me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, Komuna do të konfirmojë planin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe do të caktojë organin që do të realizojë diskutimin publik.

Diskutimi publik mund të realizohet edhe me rastin e akteve të tjera me të cilat vendoset mbi çështjet me rëndësi për popullatën lokale, në pajtim me Statutin dhe vendimin e Kuvendit.

Diskutimi publik nuk mund të zgjasi më pak se 15 ditë dhe as më shumë se 60 ditë.

Neni 171

Pjesëmarrja e popullatës lokale në vendimmarrje për punët nga neni i mëparshëm i Statutit, sigurohet sidomos:

1. që para përcaktimit të projekt planeve dhe programeve për zhvillimin e Komunës, të buxhetit dhe akteve të përgjithëshme, me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, të gjithë qytetarëve, organeve të administratës, personave juridik dhe fizik, organizatave joqeveritare dhe subjekteve të tjera të interesuara (në tekstin vijues: pjesëmarrësit e diskutimit publik) t'u mundësohet informimi mbi aktivitetet që planifikohen dhe të cilat do të realizohen gjatë vitit në nivelin e Komunës dhe të grumbullohen dëshirat, kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në ato lëmi.

2. me publikimin e projekt planit dhe programit të zhvillimit të Komunës, të buxhetit dhe akteve të përgjithëshme, me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, në mënyrë që të jetë i afërt për të gjithë pjesëmarrësit e diskutimit publik, programet e diskutimeve publike nëpër bashkësitë e veçanta lokale mbi nevojat e popullatës lokale, e veçanërisht në fushat e strehimit, të komunalieve, urbanistike dhe ekologjike, në veprimtaritë arsimore, shëndetësore dhe sociale e tj;

3. me lajmërimin për mënyrën, afatet, vendin dhe kohën e mbajtjes si dhe me informacione të nevojshme mbi lëndën për diskutimi publik;

4. me detyrimin e organeve të qeverisjes lokale që të shqyrtojnë të gjitha komentet, propozimet apo sugjestionet e arritura të pjesëmarrësve në diskutimin publik, të bëjnë rezymenë e komentit dhe qëndrimet mbi pranimin gjegjësisht arsyet për mospranim, të bëjnë raportin mbi rezultatet e diskutimit publik dhe me projekt planin dhe programin e zhvillimit të

Komunës, të buxhetit dhe akteve të përgjithshme, me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve t'ia dorëzojnë propozuesit;

5. me detyrimin që dokumentet e miratuara të jenë të afërta për publikun, e sidomos për personat me nevoja të veçanta të cilat për këtë tregojnë interesim.

IX. MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI I ADMINISTRATËS LOKALE DHE QYTETARËVE

1. STANDADET E PROCEDIMIT ME QYTETARËT

Neni 172

Organet e veteadministrimit lokal janë të detyruar që të sigurojnë realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të popullatës lokale në mënyrë ligjore dhe efikase duke respektuar personalitetin, dinjitetin e qytetarit dhe të drejtat për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit të vet.

Funkcionarët lokal zyrtarët dhe nëpunësit në marrëdhëniet me qytetarët, janë të detyruar që t'i përmbahen kodeksit etik, që ka të bëjë me ta, të përcaktuar për zyrtarët shtetërorë dhe nëpunësit.

Neni 173

Organet e veteadministrimit lokal janë të detyruar që qytetarëve për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre të japin të dhëna, sqarime dhe lajmërimet të nevojshme.

Për procedimin në çështjet qeverisëse organet e administratës lokale janë të obliguar që publikisht të publikojnë standardet e procedimit.

174

Funkcionerët lokal dhe shefat e organeve të administratës lokale janë të obliguar që të caktojnë kohën e pranimit të qytetarëve.

Në objektet publike ku janë të vendosura organet e administratës lokale dhe të shërbimeve publike duhet të vëhet dukshëm emri i organit, gjegjësisht i shërbimit publik në të dyja gjuhët, malazeze dhe shqipe.

2. VËREJTJET DHE ANKESAT E QYTETARËVE

Neni 175

Organet e administratës lokale janë të detyruar që të sigurojnë librin e përshtypjeve dhe kutinë për vërejtje, propozime dhe ankesa dhe pranimin tek shefat e organeve, për të paraqitur vërejtjet dhe kritikën mbi punën e organit apo për sjelljet jo të rregullt të nëpunësit.

Për vërejtjet e paraqitura organi kompetent është i detyruar që me shkrim të përgjigjet në afatin prej 15 ditësh nga data e pranimit të vërejtjes apo kritikës, nëse këtë e kërkon qytetari.

3. DEKONCENTRIMI I PUNËVE TË DREJTORISË

Neni 176

Me qëllim të krijimit të kushteve për kryerjen më të plotë dhe më efikase të punëve nga kompetencat e administratës lokale, sidomos në raport me realizimin e të drejtave të qytetarëve, organet e administratës lokale mund të organizojnë punën në bashkësi lokale.

Punët nga paragrafi 1 të këtij neni, mënyrën dhe vendin e kryerjes së tyre i përcakton administratori kryesor, për të cilën qytetarët duhet të njoftohen publikisht.

X. MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS LOKALE

1. ...ME ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Neni 177

Me qëllim të afirmimit të shoqërisë së hapur dhe demokratike, organet e administratës lokale bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare të vendit dhe të huaja.

Bashkëpunimi nga paragrafi 1 të këtij neni realizohet sidomos

1. me të qënurit sa më afër informacioneve;

2. me mundësimin e pjesëmarrjes në punën e grupeve punuese për përgatitjen e akteve normative ose përpilimin e projekteve dhe programeve;

3. me organizimin e diskutimeve publike të përbashkëta, të tryezave të rrumbullakëta, seminareve etj.;
4. me finansimin e projekteve të organizatave joqeveritare me interes për popullatën lokale, me kushte dhe veprime të parapara me aktet e përgjithshme të Komunës;
5. me sigurimin e të drejtës së pjesëmarrjes (karrika e zbrazët) për përfaqësuesin e organizatës joqeveritare në seancat e Kuvendit, varësisht nga problematika që shqyrtohet.

Neni 178

Kryetari i Kuvendit të komunës do t'i mundësojë përfaqësuesit të organizatës joqeveritare pjesëmarrjen në punën e Kuvendit sipas problematikës së caktuar për të cilën organizata joqeveritare tregon interes, pa të drejtë vendosjeje (karrika e zbrazët).

Mënyra dhe procedimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesit të organizatës joqeveritare në punën e Kuvendit më saktësisht do të përcaktohet me Rregulloren e Kuvendit.

Neni 179

Kryetari i Kuvendit të komunës më së paku një herë në vit do të organizojë takim pune me kryetarët e klubeve të këshilltarëve dhe përfaqësuesve të organizatave joqeveritare me qëllim të avancimit të bashkëpunimit të mëtutjeshëm.

Kryetari i Komunës më së paku një herë në vit do të organizojë takim pune të administratorit kryesor, shefave të organeve dhe shërbimeve publike dhe të përfaqësuesëve të sektorit joqeveritar me qëllim të shqyrtimit të shkallës së bashkëpunimit dhe të përparimit të bashkëpunimit të mëtutjeshëm.

2. ... ME SHËRBIMET PUBLIKE THEMELUES I TË CILAVE ËSHTË SHTETI

Neni 180

Organet e administratës lokale realizojnë bashkëpunimin me shërbimet publike dhe me personat e tjerë juridik, themelues i të cilëve është shteti, marrin pjesë në procedimin e përcaktimit dhe realizimit të planeve dhe programeve zhvillimore dhe japin propozime, sugjerione dhe mendime në pikëpamjen e realizimit të veprimtarive në territorin e komunës.

Organizatat nga paragrafi 1 të këtij neni janë të detyruara që organeve të administratës lokale, funksionarëve të komunës dhe organeve të administratës, me kërkesën e tyre t'iu dorëzojnë raportin për realizimin e planeve dhe programeve të veprimtarisë së vet në territorin e tyre.

Neni 181

Në rast të mosrealizimit të bashkëpunimit në mënyrën e paraparë me këtë Statut, organet kompetente të administratës lokale mund të lajmërojnë Qeverinë dhe të kërkojnë marrjen e masave të caktuara, me qëllim të realizimit të bashkëpunimit.

Mbi masat e ndërmarra Qeveria sipas Ligjit, lajmëron organin kompetent të administratës lokale në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit.

3. ... ME ORGANET SHTETËRORE

182.

Marrëdhëniet në mes të organeve të administratës lokale dhe të organeve shtetërore krijohen mbi bashkëpunimin e ndërsjellë dhe mbikëqyrjen e organeve shtetërore mbi ligjshmërinë e punës së organeve të administratës lokale.

Neni 183

Organet e qeverisjes lokale në kryerjen e punëve nga fushëveprimi i vet:

1. u japin organeve shtetërore iniciativa për rregullimin e marrëdhënieve të rëndësishme për administratën lokale dhe marrjen e masave me rëndësi për zgjidhjen e çështjeve në kuadër të të drejtave dhe detyrave të administratës lokale;
2. japin propozime për ndërmarrjen e aktiviteteve të organeve shtetërore për zhvillimin e administratës lokale;
3. kërkojnë mendimin nga organet kompetente shtetërore në lidhje me aplikimin e Ligjeve të cilët janë me ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin dhe realizimin e administratës lokale dhe punën e organeve të administratës lokale;
4. marrin pjesë në përgatitjen e ligjeve dhe akteve të tjera përmbajtja e të cilave është me interes për realizimin dhe zhvillimin e administratës lokale.

Neni 184

Me realizimin e bashkëpunimit me organet e administratës lokale, organet shtetërore:

1. njoftojnë organet e administratës lokale, me iniciativën e vet ose me kërkesën e tyre, mbi masat që ndërmarrin apo kanë qëllim të ndërmarrin për zbatimin e ligjit apo të dispozitave tjera për mbrojtjen e ligjshmërisë, dukuritë të cilat i shkelin dhe masat për mënjanimin, për realizimin e të drejtave të qytetarëve në administratën lokale, si dhe për çështjet tjera me interes të drejtpërdrejtë për realizimin e administratës lokale dhe punën e organeve;

2. ofrojnë ndihmë profesionale organeve të administratës lokale në lidhje me kryerjen e punëve;

3. kërkojnë raporte, të dhëna dhe njoftime për kryerjen e punëve në kuadër të të drejtave dhe detyrave të administratës lokale, si dhe për çështjet e tjera të cilat janë me interes për realizimin e funksionimit të organeve shtetërore;

4. kryejnë punë të tjera në pajtim me ligjin.

4. ...ME QEVERINË

Neni 185

Kur Kuvendi më gjatë se 6 muaj nuk mban mbledhje, nuk realizon vendimet e gjykatave kompetente ose nuk kryen detyrat e parapara me ligj, me çfarë pengohet realizimi i të drejtave të qytetarëve ose krijon dëme të mëdha materiale, Qeveria do t'ia tërheqe vërejtjen Kuvendit, që në afatin e caktuar, të sigurojë realizimin e funksioneve të veta, gjegjësisht të kryejë obligimet e përcaktuara me ligj.

Nëse Kuvendi në afatin nga paragrafi 1 të këtij neni, nuk rivendos për kryerjen së funksioneve të veta, gjegjësisht nuk i kryen obligimet e veta të parapara me ligj, Qeveria me propozimin e Ministrisë kompetente për punët e administratës lokale, do të shpërndajë Kuvendin.

Në rast të shpërndarjes, funksionin e Kuvendit deri në konstituimin e tij, e kryen këshilli I komisionerve të cilët I emron Qeveria.

Neni 186

Në rast të shpërndarjes së Kuvendit, Kryetari i Komunës shpall zgjedhjet në afatin prej 15 ditësh nga dita e shpërndarjes.

Nese Kryetari I komunës nuk shpall zgjedhjet në afat nga paragrafi 1 I këtij neni, zgjedhjet I shpall Qeveria .

XI. MBROJTJA E ADMINISTRATËS LOKALE

1. FORMAT E MBROJTJES

1.1. KËSHILLI PËR ZHVILLIMIN DHE MBROJTJEN E ADMINISTRATËS LOKALE

Neni 187

Për të realizuar ndikimin demokratik të qytetarëve për përparimin e administratës lokale, Kuvendi themelon Këshillin për zhvillimin dhe mbrojtjen e administratës lokale (në tekstin e mëtutjeshëm Këshilli).

Me vendimin për themelimin e Këshillit më hollësisht përcaktohen të drejtat dhe detyrat, përbërja dhe mënyra e zgjedhjes dhe punës së Këshillit dhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e tij.

Neni 188

Këshilli ka të drejtë që organeve shtetërore, organeve të administratës lokale dhe shërbimeve publike t'u paraqesë propozimet për përparimin dhe zhvillimin e administratës lokale, ngritjen e nivelit të kualitetit të shërbimeve publike, mbrojtjen e të drejtave dhe detyrave të Komunës të parapara me Kushtetutë dhe ligj dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të popullatës lokale.

Përfaqësuesi i Këshillit ka të drejtë të marre pjesë në seancat e Kuvendit, pa të drejtë vendimmarrjeje. Organet dhe shërbimet nga paragrafi 1 të këtij neni, janë të detyruar që të deklarohen mbi propozimet e Këshillit në afatin e përshtatshëm, e më së largëti në afatin prej 60 ditësh, nga dita e paraqitjes së propozimit.

1.2. PËRBËRJA DHE MËNYRA E ZGJEDHJES SË KËSHILLIT

Neni 189

Këshilli ka kryetarin dhe 6 anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i këshilltarëve.

Anëtarët e Këshillit zgjidhen nga radhët e qytetarëve të dalluar dhe të rëndësishëm të Komunës dhe ekspertëve nga fushat e rëndësishme për administratën lokale.

Anëtarët e Këshillit i propozojnë qytetarët, bashkësitë lokale, organizatat joqeveritare, institucionet e specializuara, shoqatat, subjektet ekonomike etj.

Neni 190

Për anëtar të Këshillit nuk mund të zgjidhen:

- deputetët dhe këshilltarët;
- funksionarët lokal, shefat e organeve të administratës lokale dhe udhëheqësit e shërbimeve publike themelues i të cilave është Komuna;
- individët e zgjedhur, të emëruar apo të instaluar në Qeverinë e Malit të Zi dhe në organet e administratës lokale;
- funksionarët e partive politike (kryetarët e partive, anëtarët e kryesisë, zëvedësit e tyre, anëtarët e këshillave ekzekutive dhe kryesore, si dhe funksionarët e tjerë partiak);
- individët të cilët plotfuqishëm janë dënuar për vepër penale ndaj detyrës zyrtare, pa marrë parasyshë sanksionet e marra, ose që janë plotfuqishëm të dënuar për ndonjë vepër tjetër penale me dënim burgimi më tepër se 6 (gjashtë) muaj;
- individët që janë në bashkëshortësi me individët e përmendur në paragrafet 1-5 të këtij neni ose me to kanë afërsi farefisnore në linie të drejtë, pa marrë parasyshë shkallën farefisnore.

Neni 191

Këshilli patjetër duhet të zgjidhet në afatin prej 60 ditësh nga data e konstituimit të Kuvendit.

Mandati i Këshillit zgjat aq sa dhe mandati i Kuvendit.

Këshilli bie rregulloren mbi punën e vet.

NDËRRIMI I STATUTIT

Neni 192

Për ndërrimin e Statutit vendos Kuvendi.

Propozimin për ndërrimin Statutit mund ta paraqesin së paku 1/3 e këshilltarëve në Kuvend, kryetari i Komunës dhe më së paku 5% e qytetarëve nga numri i të regjistruarve në listat zgjedhore të Komunës nga zgjedhjet e fundit.

Për propozimin për ndërrimin e Statutit vendos Kuvendi.

Neni 193

Kuvendi konfirmon Projekt Statutin dhe e qet në diskutim publik.

Trupi punues kompetent i Kuvendit për Statut dhe dispozita pas kryerjes së diskutimit publik mbi Projekt Statutin, do të verifikojë Propozim Statutin për miratim në Kuvend.

Propozimin për iniciimin e ndërrimit të Statutit dhe ndërrimi i Statutit janë miratuar nëse për to ka votuar shumica e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve në Kuvend.

Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit bëhen me vendim.

XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 194

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij statuti pushon të vlejë Statuti i Komunës së Ulqinit ("Fl. zyrtare e RMZ nr. 4/96 – dispozitat komunale").

Neni 195

Kuvendi në afatin prej 60 ditësh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, do të miratojë Rregulloren e punës.

Deri në miratimin e Rregullores së punës nga paragrafi i mëparshëm, do të aplikohet Rregullorja ekzistuese e kuvendit komunal.

Neni 195 a

Rregulloret dhe aktet e tjera, sjellja e obligueshme e të cilëve dhe përshtatja del nga ky vendim, do të sillen në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 195 b

Emrimi i Kryeadministratorit dhe vendosja e kryeshefave të organeve të administratës lokale në bazë të konkursit publik në afat prej 4 vjetësh, në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtij vendimi, do ta bëhet pas hyrjes në fuqi të vendimit.

Neni 196

Ky statut hynë në fuqi ditën e tetë nga data e publikimit në "Fletën zyrtare të RMZ dispozitat komunale".

Neni 196 a

Ky vendim për ndyshimet dhe plotësimet e Statutit hyn në fuqi 8 ditë nga data e publikimit në “Fletën zyrtare të MZ – dispozitat komunale .

KUVENDI KOMUNAL ULQIN

Nr. 02-3459/3-07
Në Ulqin, më 26.10.2007

KRYETAR
Muhamet Nika,d.v

Vendimi për ndyshimet e Statutit të Komunës së Ulqinit

(Vendimi është publikuar në “ Fletën zyrtare MZ- dispozitat komunale” ,nr.9/09 te datës 5.03.2009)

Nr.02-358/4-09
Ulqin,13.02.2009

KRYETAR
Muhamet Nika ,d.v

Vendimi për ndyshimet e Statutit të Komunës së Ulqinit

(Vendimi është publikuar ne “Fletën zyrtare MZ – dispozitat komunale “ nr.16/11 të datës 13.05.2011

Nr.02-622/9-11
Ulqin,13.04.2011

KRYETAR
Luigj Shkrela.v.d